

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE I VITIT
2025**

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	06.01.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumenteve zyrtare "relacion shpjegues" të disa VKM-ve të miratuara nga Këshilli i Ministrave: Nr. 446, datë 3.7.2024: “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar”. Nr. 470, datë 17.07.2024: “Për pezullimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës bashkëpunuese të Guajanës, për përjashtimin nga kërkesat për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, pasaportave të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme”. Nr. 471, datë 17.07.2024: “Për disa	20.01.2025	Vënë në dispozicion përgjigja kërkuar.	E plotë	Pa tarifë

	shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar". Nr. 512, datë 01.08.2024: “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar". Nr. 557, datë 11.09.2024: “Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar” . Nr. 558, datë 11.09.2024: “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese				
--	--	--	--	--	--

		ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar” Nr. 577, datë 18.09.2024: “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar” . Nr. 600, datë 25.09.2024: “Për një shtesë në vendimin nr. 173, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e Task-Forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuarve të mbrojtjes ndërkombëtare”, të ndryshuar”. Nr. 636, datë 10.10.2024: “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”. Nr. 661, datë 23.10.2024: “Për disa shtesa dhe ndryshime në				
--	--	---	--	--	--	--

		vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar". Nr. 700, datë 13.11.2024: "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar". Nr. 719, datë 20.11.2024: "Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Uzbekistanit, për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit". Nr. 720, datë 20.11.2024: "Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Republikës së Kirgizistanit, për përjashtimin e kërkesave për vizë për				
--	--	---	--	--	--	--

	mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”. Nr. 721, datë 20.11.2024: “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Nikaraguas, për përjashtimin e vizave për pasaportat e zakonshme, diplomatike dhe të shërbimit”. Nr. 735, datë 27.11.2024: “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar”. Nr. 869, datë 30.12.2024: “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përdorimin e fondit për blerjen e një pasurie të paluajtshme që do të shërbejë si seli e misionit diplomatik pranë Bashkimit Evropian, në Bruksel”. Nr. 870, datë 30.12.2024: “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe				
--	---	--	--	--	--

		shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar”.				
02	07.01.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të listës së personave që zotërojnë pasaportë diplomatike të vlefshme.	22.01.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj ju njoftojmë se sipas VKM – së nr. 389/2019 “Për kriteret për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe asaj të shërbimit” (e ndryshuar), Ligjit nr. 8550/ 1999 “Për statusin e deputetit” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 8577 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në RSH” (i ndryshuar), pasaportat diplomatike mund t’u jepen funksionarëve publikë dhe disa kategorive të tjera të parashikuara nga këto dispozita ligjore. Gjithashtu, pasaportat diplomatike mund t’u lëshohet bashkëshortëve dhe fëmijëve të mitur për disa prej kategorive të përcaktuara. Për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale, informacioni në lidhje me këta individë nuk mund të ndahet pa miratimin e secilit prej tyre.	E plotë	Pa tarifë
03	08.01.2025	Kërkesë për informim në lidhje me hapat e një aplikimi të dërguar në adresën e postës elektronike të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për dy prej pozicioneve të shpallura nga MEPJ pranë Misionit të RSH në BE.	28.01.2025	Në vijim të kërkesës, ju bëjmë me dije si vijon: Siç përcaktohet edhe në thirrjen për shprehjen e interesit për të shërbyer në Misionin e RSH- së pranë BE – së, në Bruksel (Shqipëri BE 2030), kandidaturat do t’i nënshtrohen një procesi shqyrtimi paraprak lidhur me pranueshmërinë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në thirrje, vlerësimin dhe intervistën nga Komisioni i Posaçëm Ndërinstitucional i përzgjedhjes. Kandidatët e		

				përzgjedhur për intervistë do të njoftohen individualisht për datën, orën dhe zhvillimin e saj.		
04	08.01.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: - listën e vendeve në të cilat shtetasit shqiptarë mund të udhëtojnë pa pasur nevojën e një vize. - Afatin e qëndrimit pa vizë për secilin prej këtyre vendeve.	27.01.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion ju bëjmë me dije si vijon: - Bashkëlidhur regjimi i vizave për shtetasit shqiptarë, më poshtë dhe linku me informacionin paraprak: https://punetejashtme.gov.al/regjimi-i-vizave-per-shtetasit-shqiptare-info-per-qytetaret-shqiptare Në fund të faqes nëpërmjet klikimit shkon në hartën e botës, përzgjedh shtetin dhe merr informacionin se si mund të udhëtohet në vendin e destinacionit. - Përveç Bjellorusisë që ka afat qëndrimi 30 ditë/180 ditë dhe Turqisë 180/360 ditë, të gjitha vendet e tjera zbatojnë afatet e qëndrimit në BE 90 ditë/180 ditë.		
05	09.01.2025	Kërkesë për informacion për të gjithë stokun e ndërtesave publike që zotëron MEPJ, dhe institucionet e varësisë.	10.01.2025	Vënë në dispozicion përgjigja kërkuar, sipas tabelës në kërkesën bashkëlidhur.	E plotë	Pa tarifë
06	10.01.2025	Kërkesë e deleguar nga Kryeministria, Ankesë në lidhje me pamundësinë e kryerjes së shërbimit për të bërë në Spanjë pasaportën e shtetases shqiptare, si rrjedhojë humbet mundësinë e votimit.	10.01.2025	Përgjigje e dhënë nga Zyra e bashkëqeverisjes.	E plotë	Pa tarifë
07	20.01.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Sa është numri i vizave për shtetasit nga Filipinet që kanë kërkuar të vijnë në	30.01.2025	Në përgjigje tuajës ju bëjmë me dije si vijon: 1. Numri në total i aplikimeve për vizë të shtetasve filipinezë në 5 vitet e fundit është 4,442 aplikime nga të	E plotë	Pa tarifë

		Shqipëri, pesë vitet e fundit? 2. Cili është qëllimi i kërkesave për vizë nga Filipinet në Shqipëri? 3. A ka kërkuar shteti i Filipineve nga MEPJ ndihmë apo asistencë për të lehtësuar problemet e këtij komuniteti të hasur në Shqipëri gjatë këtyre viteve të fundit?		cilat janë dhënë 2955 viza elektronike/ pullë. 2. Shtetasit filipinezë aplikojnë kryesisht për motive punësimi, bashkimi familjar dhe turistike. 3. Nuk rezulton të kemi patur kërkesa për ndihmë për këtë tematikë.		
08	29.01.2025	Kërkesë për informim në lidhje me një aplikim për shprehje interesi për të shërbyer në Misionin e RSH pranë BE në Bruksel. Informacion në lidhje me përzgjedhjen e kandidaturës.	12.02.2025	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ju bëjmë me dije si vijon: Siç përcaktohet edhe në thirrjen për shprehjen e interesit për të shërbyer në Misionin e RSH pranë BE, në Bruksel (Shqipëri BE 2030), kandidaturat do të nënshtrohen një procesi shqyrtimi paraprak lidhur me pranueshmërinë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në thirrje, vlerësimin dhe intervistën nga Komisioni i Posaçëm Ndërinstitucional i përzgjedhjes. Kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të njoftohen individualisht për datën, orën dhe zhvillimin e saj. Afatet ende nuk janë të përcaktuara sepse procesi i përzgjedhjes së kandidatëve nuk është vetëm në kompetencën e MEPJ, por edhe të Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit, Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe ministritë e linjës. MEPJ aktualisht ka rolin e depozituesit të aplikimeve dhe do të bashkëdrejtojë komisionin përzgjedhës pas përcaktimit bashkërisht me institucionet e tjera të datës së testimit të aplikuesve.		

09	04.02.2025	Kërkesë për kopje elektronike të akteve të mëposhtme: - Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Rendit Publik (nr. 925 datë 03.03.1999), Ministrit të Punëve të Jashtme (nr.337/1 datë 08.03.1999), Ministrit të Drejtësisë (nr.782/1 datë 25.03.1999) dhe Ministrit të Financave (nr.583/3 datë 05.03.1999) "Për procedurat që ndiqen për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim"; - Udhëzimi i Ministrit të Rendit Publik (Nr. 3583 datë 27.11.2001) dhe Ministrit të Punëve të Jashtme (nr. 6252 datë 10.12.2001) "Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare", i ndryshuar në vitin 2007.	12.02.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se pas konsultimit me strukturat përkatëse rezulton se informacioni i kërkuar nuk gjendet i administruar.	E plotë	Pa tarifë
10	07.02.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit lidhur me rolin e MEPJ në implementimin dhe koordinimin e Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko - Jonian: - Raportet e monitorimit të implementimit të kësaj strategjie për 5 vitet e fundit në Shqipëri. - Përshkrimin e procesit të raportimit dhe monitorimit të implementimit të strategjisë, duke	10.02.2025	Kërkesa i është deleguar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit të SASPAC.	E plotë	Pa tarifë

		përfshirë institucionet e përfshira dhe metodat e ndjekura. - Institucionet ose organet ndaj të cilave MEPJ raporton këtë strategji.				
11	13.02.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: - Qëndrimin e Shqipërisë për procesin e pasivizimit të adresave në Luginën e Preshevës? Si është adresuar kjo çështje? - Ai ka mbështetur Shqipëria shqiptarët në Luginë të Preshevës? Nëse po, si? - Si mund të zgjidhet çështja e të drejtave të shqiptarëve dhe pajisjes së tyre me mjet identifikimi që u mundëson ushtrimin e çdo të drejte brenda shtetit si banorë autoktonë në Luginë të Preshevës?	21.02.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion ju përcjellim informacionin si vijon: 1. Cili është qëndrimi i Shqipërisë për procesin e pasivizimit të Adresave në Luginën e Preshevës? Si është adresuar kjo çështje? Problemi i pasivizimit të adresave të bashkëkombësve tanë në Luginën e Preshevës ka qenë dhe mbetet një shëtitim i përhershëm i politikës dhe diplomacisë shqiptare. Qeveria shqiptare ka kërkuar dhe do të vijojë të kërkojë për shqiptarët e Luginës, më shumë mirëqenie, më shumë respekt dhe më shumë përfshirje në jetën e vendit dhe proceset integruese. Kjo ka qenë një kërkesë konstante e qeverisë shqiptare në të gjitha takimet me zyrtarët më të lartë të Serbisë duke filluar nga viti 2014 (vizita e parë e KM Rama në Serbi, nëntor 2014). Është e nevojshme të sqarojmë se efektet e ligjit të miratuar nga Parlamenti serb në vitin 2011 “Për rezidencën e përkohshme dhe të përhershme” i shtrijnë efektet jo vetëm mbi përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Serbi, por mbi gjithë shtetasit e këtij vendi. Ajo që përbën shqetësim për diplomacinë shqiptare qëndron në faktin se ky ligj	E plotë	Pa tarifë

			zbatohet në mënyrë diskriminuuese, selektive, disproporcionale, duke bërë që në raport me popullsinë, komuniteti shqiptar që jeton në Serbi të jetë më i prekuri nga ky ligj, çfarë rezulton me pamundësimin e ushtrimit të disa të drejtave dhe marrjes së shërbimeve të ndryshme. Ky shqetësim ka qenë dhe mbetet pjesë e dialogut politiko-diplomatik midis vendit tonë dhe Serbisë, ndërkohë që këtë problem e kemi ngritur në vijimësi dhe bërë pjesë edhe të diskutimeve në organizatat ndërkombëtare, ku të dyja shtetet janë anëtare. Falë këtij insistimi të palës shqiptare, çështja e pasivizimit të adresave ka qenë objekt analizash dhe diskutimesh nga ana e strukturave, apo forumeve të OSBE-së për të cilat është përgatitur edhe një raport. Po ashtu, edhe BE është angazhuar në këtë proces. Në nëntor të vitit të kaluar zëdhënësja e Komisionit Evropian, Ana Pisonero, evidentoi faktin se Komisioni Evropian i kërkoi shpjegime Serbisë për këtë çështje. Ne vijim ajo theksoi se çështja e pasivizimit të adresave, me theks të veçantë për mënyrën se si aplikohet ndaj komunitetit shqiptar në Serbi, do të jetë pjesë e procesit të integritetit të këtij vendi (Serbisë) në BE, si dhe pjesë e raportimeve vjetore në procesin e integritetit (Çështja është përmendur tashmë në Progresraportin 2024 për Serbinë, të hartuar nga BE-ja, si dhe në raportin e Departamentit amerikan të	
--	--	--	--	--

			Shtetit për të drejtat e njeriut në Serbi, për vitin 2023). Pavarësisht justifikimit të palës serbe se procesi i pasivizimit është thjesht teknik dhe se nuk ka paragjykime të karakterit kombëtar, kjo çështje tashme është bërë pjesë e agjendës së bashkëpunimit që Serbia ka me BE, OSBE, KiE, etj. dhe padyshim pjesë e dialogut diplomatik midis Shqipërisë dhe Serbisë. MEPJ ka reaguar shpeshherë edhe publikisht (dalja e fundit publike me 21 nëntor 2024), duke tërhequr vëmendjen se ky problem, që nuk duket se ka të bëjë vetëm dhe thjesht me zbatimin e një ligji, targeton shqiptarët në Luginën e Preshevës, duke u pamundësuar atyre qasjen në shërbime, apo ushtrimin e të drejtave të tyre. 2. A i ka mbështetur Shqipëria shqiptarët e Luginës së Preshevës? Nëse po, si? Referuar periudhës së fundit mbështetja ndaj shqiptarëve të cilët jetojnë në trojet e tyre në Luginën e Preshevës, ka qenë e gjithanshme dhe në shumë plane. Në planin zyrtar, vetëm gjatë vitit të kaluar autoritetet më të larta shqiptare kanë zhvilluar takime me gati gjithë drejtuesit politike të faktorit shqiptar në Luginë: me Kryetaren e Komunës së Preshevës, znj. Ardita Sinani, me të vetmin deputet Shqiptar në parlamentin e Serbisë, z. Shaip Kamberi, me Kryetarin e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve		
--	--	--	--	--	--

			në Serbi, me drejtuesit e subjekteve politike shqiptare, etj. Këto takime i kanë shërbyer jo thjesht njohjes më të mirë të problematikës me të cilën ndeshen shqiptarët në Luginë, por edhe shkëmbimit të mendimeve për një qasje të përbashkët, për një zgjidhje sa më optimale të tyre. Me qëllim ndjekjen e përditshme të problematikës me të cilën ballafaqohen bashkëkombësit tanë në rajon, si dhe nxitjen e një bashkëpunimi më të efektshëm në të gjitha fushat me ta, tashmë në MEPJ është ngritur dhe funksionon Drejtoria për Bashkëpunimin me Faktorin Shqiptar në Rajon. Ndërkohë autoriteteve serbe i është përcjelle kërkesa për çeljen e një përfaqësie konsullore në nivel Konsullate të Përgjithshme shqiptare në Luginë, çka përbën një hap konkret në kuadër të rritjes së prezencës sonë dhe të bashkëpunimit me bashkëkombësit tanë. Gjithashtu, nga ana e qeverisë shqiptare janë alokuar disa herë fonde në mbështetje të Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Serbi, është mundësuar përdorimi online i abetares dhe disa programeve të tjera të gjuhës dhe kulturës shqipe, jemi në proces të sigurimit të librave artistikë - pjesë e programit mësimor - për shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme në gjuhën shqipe në Luginë, si dhe kemi mbështetur financiarisht disa projekte të Komunitetit të Presheves - Panairin e Librit dhe disa projekte të		
--	--	--	--	--	--

			tjera me ndikim në bizneset e reja (start-up-e të grave kryefamiljare). Qeveria shqiptare ka subvencionuar një donacion prej 70 mijë euro për rinovimin e ndërtesës së KKSH në Bujanoc, ndërsa Bashkia e Tiranës, me vendim të Këshillit të Ministrave, ka bërë dy donacione 550 mijë euro për ndërtimin e palestrës dhe 520 mijë euro për rinovimin e shkollës fillore "Dituria" në fshatin Corropice në Komunën e Preshevës. Duke vlerësuar si një prioritet absolut përgatitjen e kuadrove të mirë arsimuar nga Lugina (diplomat e marra në Shqipëri njihen nga pala serbe, gjë që mundëson punësimet), për vitin arsimor në vijim janë dhënë 36 bursa së bashku me mbështetjen për akomodim nga universitetet publike të Tiranës, Elbasanit, Gjirokastrës dhe Vlorës. Po ashtu, për vitin akademik 2025-2026 do t'i bashkohen këtij numri edhe bursat (rreth 30), të cilat do te jepen nga universitetet publike të Korçës, Shkodrës, Western Balkan University, etj. Ky proces vijon. Efekte mjaft pozitive kanë dhënë edhe binjakëzimet midis bashkive shqiptare të Gjirokastrës, Elbasanit dhe në vijim asaj të Korçës me Komunën e Preshevës dhe Bujanocit, për sa i përket shkëmbimit të eksperiencave në administrimin vendor dhe rritjes së bashkëpunimit në fushën e artit, kulturës, ruajtjes së traditave, turizmit, ruajtjes së	
--	--	--	---	--

			ambientit, etj. Po punohet edhe për rritjen e bashkëpunimit ekonomik. Gjatë këtij viti do të hapet zyra e Dhomës së Tregtisë e Industrisë së Tiranës në Luginën e Preshevës, që do të mundësojë intensifikimin e bashkëpunimit dhe ndihmës. Kanë filluar të rriten, gjithashtu, edhe aktivitetet dhe ndërveprimi në fushën e artit, shkencës, teatrit, sportit. Për herë të parë në vitin 2024, Ambasada e RSH në Serbi organizoi Pritjen Zyrtare me rastin e Festës Kombëtare të Shqipërisë në Luginën e Preshevës. Vlen të nënvizojmë se Qeveria e RSH-së në bashkëpunim edhe me Qeverinë e Kosovës vazhdojnë të punojë me përkushtim për konsolidimin e marrëdhënieve politike me shqiptarët në rajon, përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike e sociale, kultivimin dhe forcimin e identitetit kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. 3. Si mund të zgjidhet çështja e të drejtave të shqiptarëve dhe pajisja e tyre me mjete identifikimi që ju mundëson ushtrimin e çdo të drejte si banorë autoktonë të Luginës së Preshevës? Në përgjigje të pikës së parë dhe të dytë kemi dhënë informacionin për sa i përket angazhimit të shtetit shqiptar në zgjidhjen e këtij problemi në rrugën politiko-diplomatike. Por krahas	
--	--	--	---	--

				kësaj, opsion mbetet dhe zgjidhja ligjore e saj. Kjo do të thotë që shtetasit me kombësi shqiptare që jetojnë në Serbi, të cilëve iu janë cenuar të drejtat si rezultat i zbatimit të këtij ligji, të kërkojnë zgjidhje në strukturat gjyqësore të Serbisë. Pavarësisht se deri tani strukturat gjyqësore të Serbisë nuk i kanë konsideruar të bazuara pretendimet e shtetasve të Serbisë me kombësi shqiptare, në ndonjë rast për efekt të mos respektimit të afateve dhe në raste të tjera, për probleme të karakterit administrativ, ajo që zgjidh ligjërisht dhe përfundimisht në planin ligjor këtë problem, është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg.		
12	14.02.2025	Kërkesë për informacion për tenderat e biletave të udhëtimit dhe akomodimin e punonjësve. 1. Sa është kostoja totale vjetore e shpenzimeve për blerje bileta udhëtimi nga MEPJ (periudha 1 Janar 2024 – 31 dhjetor 2024)? 2. Sa është kostoja totale e akomodimit që shpenzoi MEPJ në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar? 3. Sa procedura ka fituar firma “AVIA CENTER” me NIPT M22128040F? Në çfarë datash dhe me çfarë vlerash? 4. A janë realizuar të gjitha udhëtimet apo akomodimet që ka	24.02.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion ju bëj me dije si vijon: 1. Për vitin kalendarik 2024 (janar – dhjetor) shpenzimet për shërbim blerje të biletave të transportit ndërkombëtar ajror në sistemin dinamik është 11,849,308 lekë. 2. Kostoja e shpenzimeve të akomodimit që ka paguar Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për periudhën janar – dhjetor 2024 është 5,862,483 lekë. 3. Operatori ekonomik “Avia Center” me NIUS M22128040F ka fituar dy procedura, përkatësisht: - Blerje të biletave të transportit ndërkombëtar ajror me destinacion Tiranë – Barcelonë – Tiranë (2 persona) datë 17.10.2024 në vlerën	E plotë	Pa tarifë

		fituar “AVIA CENTER”? Nëse jo, për çfarë arsye?		80,000.00 lekë. Blerje të biletave të transportit ndërkombëtar ajror me destinacion Tiranë – Londër – Tiranë (1 person) datë 08.11.2024 në vlerën 19,300.00 lekë. 4. Për të dyja procedurat e lartpërmendura (në pyetjen 3) është marrë shërbimi sipas Ftesës për Ofertë. Të gjitha vlerat e mësipërme janë ezauruar në përputhje me ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe akteve të dala në varësi të tij.		
13	17.02.2025	Kërkesë drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë për të bërë një fjalim të shkurtër drejtuar shqiptarëve që jetojnë në Gjermani në lidhje me zgjedhjet e parakohshme që po zhvillohen.	18.02.2025	Deleguar Kryeministrit	E plotë	Pa tarifë
14	18.02.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Organigramën e drejtorisë/ zyrës së komunikimit. 2. Nr. e punonjësve me kontratë të plotë për komunikimin dhe pozicionin përkatës (p.sh. specialist për media/ specialist për faqen e internetit/ kameraman, fotograf etj.). 3. Nr. e punonjësve me kontratë të përkohshme për sektorin e komunikimit dhe pozicionin përkatës. 4. Fondin vjetor të alokuar për këtë sektor për vitet 2022, 2023, 2024, 2025 dhe mënyrën e	25.02.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj përcillet informacioni si më poshtë vijon” 1. Organigrama aktuale e Drejtorisë së Komunikimit është 1+4 punonjës. 2. Nuk ka. 3. Nuk ka 4. Fondi i alokuar si vijon: Viti 2021 , Sektori i Diplomacisë Publike (12 muaj), Përgjegjës sektori, 2 specialistë, 218,760 fondi mujor i pagave dhe 2,625,120 fondi vjetor i pagave; Viti 2022 , Sektori i Diplomacisë Publike (12 muaj), Përgjegjës sektori, 2 specialistë, 238,600 fondi mujor i pagave dhe 2,863,200 fondi vjetor i pagave; Viti 2023 , Sektori i Diplomacisë Publike (12	E plotë	Pa tarifë

		shpërndarjes së tij (p.sh. Fondi i pagave, fondi për aktivitete publike etj.). 5. Sa ka ndryshuar numri i punonjësve për Drejtorinë/ zyrën e komunikimit për vitet 2021, 2022, 2023, 2024, 2025.	muaj), Drejtor, 4 specialistë, 599,720 fondi mujor i pagave dhe 7,196,640 fondi vjetor i pagave; Viti 2024, Sektori i Diplomacisë Publike (janar – gusht), Drejtor, 4 specialistë, 669,260 fondi mujor i pagave dhe 5,354,080 fondi vjetor i pagave; Viti 2024, Drejtoria e Komunikimit (shtator – dhjetor,) Drejtor, 4 specialistë, 0 fond mujor i pagave dhe 0 fond vjetor i pagave; Viti 2025, Drejtoria e Komunikimit (janar – shkurt), Drejtor, 4 specialistë, 0 fond mujor i pagave dhe 0 fond vjetor i pagave. 5. Sipas Urdhrave përkatës të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së MEPJ, vijon si më poshtë: Për vitin 2021 (Urdhri i KM, nr. 145, datë 04.11.2020), Drejtoria e Diplomacisë publike dhe Diasporës, Sektori i Diplomacisë Publike dhe Komunikimit kishte 1+2 punonjës; Për vitin 2022 (Urdhri i KM, nr. 55, datë 18.03.2022), Drejtoria e Diplomacisë publike dhe Diasporës, Sektori i Diplomacisë Publike dhe Komunikimit kishte 1+2 punonjës; Për vitin 2023 (Urdhri i KM, nr. 5, datë 17.01.2023), Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës kishte 1+4 punonjës; Për vitin 2024 e në vijim (Urdhri i KM nr. 135, datë 30.07.2024), Drejtoria e		
--	--	--	---	--	--

				Komunikimit ka 1+4 punonjës.		
15	26.02.2025	Kërkohet informacion sipas faktit: Me shkresën nr. 10806, dt. 4.7.2023, ish Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj, Olta Xhaçka, i ka përcjellë Kryeministrit propozimin për emërimin tim Ambasador në Hungari. Pas miratimit nga ana e Kryeministrit Rama, kandidatura ime i është përcjellë Komisionit të Politikës së Jashtme të Kuvendit si dhe Presidentit të Republikës për Dekretim. Në dt. 17.7.2023 kam dalë përpara Komisionit të Politikës së Jashtme të Kuvendit ku kam marrë mbështetjen e të gjithë deputetëve prezent në atë mbledhje për miratimin e kandidaturës time për të qenë ambasador në Hungari. Me shkresën nr. 3027/1, dt. 31.10.2023, Sekretarja e Përgjithshme e institucionit të Presidentit të Republikës, e kthen kandidaturën time në MEPJ me arsyetimin: "Lidhur me propozimin e ardhur për emërimin e z. Qirjako Qirko kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Hungarisë, kërkojmë nga ana juaj rivlerësimin e kësaj candidature, sipas kuadrit ligjor të shërbimit të jashtëm".	12.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Propozimi i MEPJ për kandidaturën tuaj si ambasador i RSH në Ambasadën e Hungarisë, nuk është pranuar nga autoritete të tjera shtetërore përgjegjëse, siç është Institucioni i Presidentit. Në këtë procedurë MEPJ gëzon vetëm të drejtën e propozimit, ndërsa instituti i Presidentit është institucion vendimmarrës. Referuar nenit 14 të Ligjit nr.23/2015 "Për shërbimin e jashtëm", Ministri ka përgjegjësinë të drejtë të Shërbimit të Jashtëm, ku ndër të tjera edhe diskrecionin për të propozuar kandidaturën e kreut të misionit diplomatik (neni 26 i ligjit). Referuar kësaj të drejte ligjore, ministri organizon strukturën e Shërbimit të Jashtëm për diplomatët mbi kriteret ligjore kushtëzuese, pa kapërcyer kompetencën ligjore. Në referencë të sa më sipër, duke qenë se sistemi i karrierës diplomatike në Shërbimin e Jashtëm është periodik i vazhdueshëm, i jep mundësinë çdo diplomati të kontribuojë dhe të përfitojë gjatë këtij shërbimi në pozicione të ndryshme, në përputhje me kufizimet ligjore. Gjithashtu, lidhur me emërimin tuaj në kategorinë ekzekutive, ju	E plotë	Pa tarifë

	Pas kalimit të një periudhe dy mujore, me Urdhrin nr. 488, dt. 26.12.2023 të Ministrit Hasani jam emëruar specialist në Drejtorinë e Detit dhe Marrëdhëniet me Gjykatat Ndërkombëtare. Në vijim me Urdhrin nr. 710, dt. 23.8.2024 jam emëruar specialist në Drejtorinë e Bashkëpunimit me Faktorin Shqiptar në Rajon. Për sa më lart dhe në bazë të ligjit të sipërcituar kërkoj të informohem si vijon: 1.Cili ka qenë reagimi dhe vlerësimi i Ministrit Hasani lidhur me kërkesën e parashtruar nga Presidenca dhe cilat kanë qenë shkaqet për të cilat nuk u ripërtëri kërkesa për të qenë kandidat për ambasador në Hungari? 2.Prej gati 20 vjetësh mbaj gradën diplomatike Ministër Fuqiplotë dhe ndërkohë duke filluar nga viti 1992 kam qenë drejtues i disa drejtorive në këtë institucion, Sekretar i Përgjithshëm i MEPJ, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Ambasador në Vendet e Ulta dhe në Britaninë e Madhe. Në të gjitha rastet, duke filluar nga viti 1992 dhe bazuar në ligjet për nëpunësin civil (duke filluar nga ai i vitit 1996 dhe deri ligji aktual) kam patur pozicione jo më pak se nivel i mesëm drejtues	sqarojmë se ligji nr. 23/2015 nuk kushtëzon MEPJ për emërimin e diplomatëve të karrierës në pozicione të caktuara për shkak të gradës diplomatike apo pozicioneve të mëparshme që ato kanë mbajtur. Përkundrazi, parashikimet ligjore me qëllim trajtimin sa më dinjitoz të diplomatëve të karrierës, u ka ofruar atyre siguri financiare në përputhje me gradën diplomatike pavarësisht pozicionit që mbajnë në shërbimin e jashtëm. Për sa më sipër, emërimi juaj për shkak të ristrukturimit është kryer në përputhje me parashikimet ligjore, me gradën diplomatike dhe në bazë të pozicioneve drejtuese të lira në strukturën e MEPJ.		
--	---	--	--	--

		deri në TND. Aktualisht pozicioni i punës, referuar ligjit 152/2013 është ai i nivelit më të ulët, "ekzekutiv". Cili është shkaku i një emërimi të tillë dhe si është proceduar për këto emërimet? Si janë respektuar procedurat ligjore për dy emërimet e fundit? Bashkëlidhur të përcillen edhe kopje të urdhrave të personave që kanë përgatitur, miratuar dhe përcjellë tek Ministri këto dy projekt urdhra.				
16	06.03.2025	Kërkohet informacion sipas faktit: Me shkresën nr. 1115 prot., datë 08.11.2024, i jemi drejtuar z. A. S. Me kërkesë për pajisjen me pasaporta shërbimi për trupën gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Rezulton se deri tani nuk ka një përgjigje.	03.06.2025	Në përgjigje Tuajës nr. 1115 prot., datë 08.11.2024 ju bëjmë me dije se procedura e brendshme e MEPJ ka përfunduar dhe mund të paraqiten për të aplikuar. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim pranë Drejtorisë së Çështjeve Konsullore është: 1. Kuponi për pasaportë me procedurë normale i cili rimbursohet plotësisht nga institucioni që ka përcjellë kërkesën dhe kushton 75 mijë lekë të vjetra (gjendet në çdo zyrë poste). 2. Karta e vlefshme e identitetit ose kuponit i aplikimit për kartë identiteti (për të rritur).		
17	10.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me kriteret e punësimit të një shtetasi shqiptar në ambasadat dhe konsullatat shqiptare në shtetet ku ato janë hapur përkatësisht.	18.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj ju bëjmë me dije se punësimi në Shërbimin e Jashtëm, nuk bëhet me emërim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, por nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin	E plotë	Pa tarifë

				civil”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me Ligjin nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të RSH – së”. Sa më sipër, procedura e pranimet në shërbimin civil dhe atë të jashtëm, organizohet dhe ndiqet deri në përfundimin e procedurës së pranimet, nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), që është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore. Vendet vakante në MEPJ, pasqyrohen në faqen zyrtare të DAP: https://www.dap.gov.al		
18	21.03.2025	Kërkesë për informacion në vijim të kërkesës nr. 16 të Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të vitit 2025, kërkohet përgjigje për sa më poshtë: “1.Nga ana juaj jam informuar se ". Propozimi i MEPJ për kandidaturën tuaj si Ambasador i RSH në Hungari nuk është pranuar nga autoritetet e tjera përgjegjëse siç është institucioni i Presidentit". Kjo përgjigje është jo vetëm e pasaktë por deformon edhe realitetin pasi Presidenca me shkresën 3027/1, dt 31.10.2023, sikurse e kam cituar të plotë në kërkesën time, nuk shprehet për mosmiratim të kandidaturës por për rivlerësim të saj. Për shkak të funksionit të Sekretari të Përgjithshëm të MEPJ, detyrë e kryer nga ana ime ne vitet 2013-2016, në çdo rast kur Presidenti i Republikës	09.04.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2025, me nr. rendor 20, ju bëjmë me dije si vijon: Pas përcjelljes së kërkesës pranë strukturave përkatëse për trajtim është vlerësuar se nuk disponohet e dhënë tjetër shtesë përse ju kemi komunikuar në email e datës 12.03.2025.	E plotë	Pa tarifë

		nuk ka miratuar kërkesën e përcjellë nga ana e MEPJ është shprehur qartë për mosmiratimin e saj. Në rastin tim Presidenti kërkon rivlerësim të kësaj kandidature, sipas kuadrit ligjor te shërbimit të jashtëm". Më duhet t'ju bëj me dije se Ligji 23/2015 parashikon vetëm dy raste mos pranimin e kandidaturës për ambasador dhe konkretisht, kur nuk plotëson kushtin e sigurisë dhe atë të pastërtisë. Ky detyrim buron nga neni 38 pika 1 dhe 2 i Ligjit 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm në RSH" e cila thotë: 1. Personeli diplomatik, teknik dhe administrativ i Shërbimit të Jashtëm, i nënshtrohet verifikimit të sigurisë dhe pastërtisë së figurës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe këtij ligji 2. Procedura e verifikimit të pastërtisë të figurës përcaktohet në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm. Rregullorja e Shërbimit të Jashtëm të RSH është miratuar e VKM nr 816, dt 7.10.2015 ku në Kreun 10 pika 2 është përcaktuar: "Në kuptimin e nenit 38 te Ligjit 23/2015 me verifikim të sigurisë				
--	--	--	--	--	--	--

	kuptohet lëshimi i certifikatës së sigurisë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe verifikimi i pastërtisë kuptohet lëshimi i vërtetimit nga institucioni përkatës se personi nuk ka qenë bashkëpunëtor i SSH." Sikurse rezulton nga dokumentacioni që administron kjo Ministri certifikata e sigurisë për mua, të paktën 27 vjet, ka qenë në nivel "Tepër Sekret" apo dhe "Sekret" këto 1.5 vjetët e fundit. Gjithashtu edhe Autoriteti i Dosjeve të ish Sigurimit të Shtetit me vendimin 52 të vitit 2018 dhe me vendimin 7 të vitit 2023 konfirmon se nuk kam qenë bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit. Atëherë pyetja që kam parashtruar në kërkesën time të parë dhe nuk kam marrë përgjigje është se cili ka qenë reagimi dhe vlerësimi i Ministrit Hasani lidhur me kërkesën e parashtruar nga Presidenca dhe cilat kanë qenë shkaqet për të cilat nuk u ripërti kërkesa për të qenë kandidat për ambasador në Hungari ? Me këtë rast ju informoj se në takimin që kam zhvilluar me Ministrin Hasani, pas vonesës në dekretimin tim nga ana e Presidentit, nga ana e tij (Ministrit Hasani) kam marrë garancinë se Qirjako mos u shqetëso, me Presidentin do të				
--	---	--	--	--	--

		komunikoj unë dhe ne nuk kemi kandidat tjetër për ne Hungari veç teje". Mbetem në pritje të një përgjigje të saktë dhe ligjore për këtë çështje. 2. Edhe për sa i përket pyetjes së dytë të parashtruar nga ana ime përgjigja juaj nuk i referohet realitetit ligjor që rregullon si statusin e nëpunësit civil ashtu dhe atë të diplomatit. Nga ana ime u shtrua pyetja: Cili është shkaku i një emërimi të tillë dhe si është proceduar për këto emërimet? Si janë respektuar procedurat ligjore për dy emërimet e fundit? Bashkëlidhur të përcillen edhe kopje të urdhrave të personave që kanë përgatitur, miratuar dhe përcjellë tek Ministri këto dy projekt urdhra. Neni 41 i Ligjit 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të RSH" ja referon procedurat e emërimit, mbarimit të detyrës në shërbimin e jashtëm Rregullores së Shërbimit të Jashtëm e cila, sikurse e përmendëm më lart është miratuar me VKM 816, dt 7.10.2015, Kreu i VII i të cilit ka përcaktuar procedurat që ndiqen për emërimin dhe mbarimin e detyrës në Misionet diplomatike për diplomatet që kthehen në Atdhe. Kam				
--	--	---	--	--	--	--

kërkuar se si është respektuar procedura e përcaktuar nga Kreu i VII i sipërcituar dhe nuk kam marre përgjigje. Kam kërkuar dokumentacionin e përgatitur për këtë rast nga drejtoria e Burimeve Njerëzore etj, për rastin tim dhe nuk më janë përcjellë.

Kam kërkuar se si janë respektuar procedurat ligjore për dy emërimet e fundit dhe nga ana juaj me thuhet se ". ligji nr. 23/2015 nuk kushtëzon MEPJ për emërimin e diplomatëve të karrierës në pozicione të caktuara për shkak të gradës diplomatike apo pozicioneve të mëparshme që ato kanë mbajtur. Përkundrazi, parashikimet ligjore me qëllim trajtimin sa më dinjitoz të diplomatëve të karrierës, u ka ofruar atyre siguri financiare në përputhje me gradën diplomatike pavarësisht pozicionit që mbajnë në shërbimin e jashtëm."

Konkluzioni juaj është i pasaktë dhe i pabazuar ligjërisht.

Sqaroj se sikurse e kam përmendur edhe më parë, ne periudhën 2013-2016 kam kryer detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ që dmth kam pasur statusin TND. Në vijim për një periudhë 7 vjeçare kam kryer detyrën e Ambasadorit të RSh në Mbretërinë e Bashkuar. Grada diplomatike gjatë gjithë kësaj kohe ka qenë

		Ministër Fuqplotë. Sikurse e dini, statusi i diplomateve rregullohet nga Ligji 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe Ligji 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të RSH". Neni 19 i Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" ka bërë klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil dhe pika 4 e nenit të sipërcituar ka klasifikuar si nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtues : a. Sekretarët e përgjithshëm, b. Drejtor departamenti c. Drejtor drejtorie të përgjithshme d. Pozicione të barasvlershme me tre të parat. Sikurse e dini për shkak të detyrës që kam kryer, Sekretar i Përgjithshëm, por edhe për shkak të gradës diplomatike që mbaj, Ministër Fuqplotë, paga kësaj grade të fundit është e njëjtë me atë të nivelit Drejtor Drejtorie të Përgjithshme. Pra pika d) e nenit të sipërcituar e konsideron mbajtësin e gradës diplomatike Ministër Fuqplotë në nivelin e kategorisë së lartë drejtues. Pika 3 e nenit 30 të Ligjit 152/2013 ka përcaktuar se : "Një anëtar i TND mund të emërohet edhe në një pozicion të kategorisë së				
--	--	---	--	--	--	--

		mesme drejtuese me pëlqimin e tij dhe të DAP-it. " Në rastin tim ndonëse kam statusin TND emërohem në nivel ekzekutiv, duke u ulur katër shkallë çka është totalisht e paligjshme dhe ca më keq duke mos marrë as pëlqimin tim dhe as miratimin e DAP-it. Nga ana tjetër vetë ligji 23/2015 në frymë dhe në përmbajtje nuk e njeh uljen në detyrë, pa shkaqe ligjore. Kjo është edhe arsyeja që në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm, në Kreun VI seksioni 3 flitet për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë dhe kriteret për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë janë: a) aftësia profesionale b) përvoja individuale e diplomatit etj.”				
19	21.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me shkresën përcjellëse nr. 1400, datë 03.07.2024 të Ambasadës së Izraelit, mbi emetimin e një pulle të përbashkët midis dy vendeve. Gjithashtu kërkohen sugjerime dhe ide mbi tematikat që mund të trajtohen si mundësi për emetimin e një pulle të përbashkët	07.04.2025	Referuar emailit tuaj, lidhur me emetimin e një pulle të përbashkët pas propozimit izraelit, sjellim në vëmendje se MEPJ i është drejtuar Postës Shqiptare me shkresën Nr. 10193/1 datë 09.07.2024 me anë të së cilës evidentohen marrëdhëniet shumë të mira me Shtetin e Izraelit dhe se ajo nxit çdo iniciativë me interes reciprok mes dy vendeve. Pra, MEPJ mbështet dhe emetimin e një pulle të përbashkët. Lidhur me tematiken e pullës, ajo mund të pasqyrojë 35 vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve (mbushen në vitin	E plotë	Pa tarifë

				2026), ose shpëtimin e hebrenjve nga shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore.		
20	25.03.2025	Kërkesë për informacione deleguar nga Ministria e Mbrojtjes: My name is E. M. I'm a Ukrainian journalist for LIGA.net, one of Ukraine's oldest and most recognized online media. Our editorial board is working on an article about how the structure of Europe's defense is changing. We would appreciate your help in providing quality coverage of this topic by answering the following questions by April 2: Do you see a need for new security alliances to protect Europe? What should the new security architecture in Europe be based on? What is Ukraine's place and role in protecting Europe from potential threats? What steps can be taken to minimize the negative consequences of a potential reduction in U.S. troop levels in Europe? You can find the official request from the editorial board attached. LIGA.net's editorial team would appreciate your input in analyzing the European security situation. Your perspective on this consequential issue would greatly contribute to public understanding. We look forward to your	15.04.2025	In response to your request for information, we would like to inform you as follows: Talking points on future Europe's defense structure • The current international security environment is marked by heightened strategic competition and threats that transcend borders and geography. • We firmly believe that at the current juncture, the global security challenges are too great to face separately, demanding transatlantic bond, USA and EU cooperation, characterized by continued transatlantic unity and cohesion. • The war in Ukraine has also reaffirmed the necessity of a stronger and more coordinated NATO-EU partnership. The security of Europe remains a shared responsibility on both sides of the Atlantic. We commend the intensified cooperation between NATO and the EU in response to the war and the increasing hybrid threats we face. • However, as this partnership evolves, it is crucial to ensure the involvement of non-EU NATO Allies in all relevant security initiatives. European security cannot be divided between EU and non-EU members, while our approach must be comprehensive and inclusive. • Stepping up Europe's efforts in defence	E plotë	Pa tarifë

		reply and future cooperation.		spending, should be a common priority for all European countries. We need to invest more for our common security. As we confront evolving and multidimensional threats, ensuring fair burden-sharing among Allies and Europe is of paramount importance. • We are fully aware that the necessity to increase military spending is dictated by the threats we face today, and it is not merely about meeting expectations. The United States' push in NATO for increased military contributions from European Allies and Canada, reflects shared responsibility among all of us. • Supporting Ukraine's fight for peace remains crucial for European security. In this regard, we commend the United States, particularly President Trump's efforts, UK and France leading efforts toward achieving a just and sustainable peace. • Peace should be negotiated from a position of strength, requiring steadfast Allied support. We believe that is crucial to maintain our support to Ukraine, ensuring it has the necessary resources to prevail. • We believe that is in our duty to fully support Ukraine's inherent right to self-defense and its reconstruction efforts, while we will continue to support it's fight for sovereignty, independence and territorial integrity. • Meantime, the Russian Federation remains the primary long-term, most	
--	--	-------------------------------	--	--	--

			significant and direct threat to Euro-Atlantic security, while the China-Russia nexus poses another serious threat to the Alliance and beyond. They have in common the aspiration of an alternative world order while advocating values that violate freedom and democracy. • The European security relies on unity, strength, and strategic foresight. The challenges we face require unwavering commitment, decisive action, and a reinforced transatlantic bond. • Today, we stand at a defining moment for European security. The war in Ukraine has reinforced the urgent need for stronger transatlantic unity and deeper NATO-EU cooperation. • We firmly believe that Ukraine's struggle is a fight for the very principles that define our Alliance: sovereignty, territorial integrity, and the right of nations to determine their own future. Albania will stand behind any European decision that supports Ukraine's fight for freedom. • Albania, as both a NATO Ally and an aspiring EU member, fully supports all efforts that enhance NATO-EU complementarity. Our goal must be to eliminate duplication, maximize resources, and ensure that all Allies, regardless of EU membership, contribute effectively to regional and global security. • Albania remains firmly committed to supporting	
--	--	--	---	--

				Ukraine, strengthening NATO-EU cooperation, and taking on greater responsibility in European security. The challenges we face demand unity, determination, and action.		
21	26.03.2025	Kërkesë për informacion si më poshtë vijon: 1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024? 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)? 3. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2024? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka pasur më shumë se një formë. 4. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka pasur më shumë se një formë. 5. Cili ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka pasur më shumë se një formë. 6. Keni ofruar mbështetje jo financiare gjatë vitit 2024? Cila është baza ligjore/ rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje? 7. Nëse keni ofruar	15.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije si vijon: 1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024? MEPJ gjatë vitit 2024 nuk ka ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse. 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)? MEPJ nuk ka ofruar mbështetje në asnjë nga format e listuar. 3. Cili ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka pasur më shumë se një formë. Nuk ka patur buxhet të disbursuar për organizatat jofitimprurëse. 4. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo financiare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj.)? MEPJ gjatë vitit 2024 nuk ka ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse.	E plotë	Pa tarifë

	mbështetje financiare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo financiare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)? 8. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2024? 9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 11. Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juaj? 12. Sa përqind (%) e projektligjeve / akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të? 13. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në to? 14. A janë të përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshirë në to?				
--	--	--	--	--	--

22	26.03.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me: 1. A po negocion Qeveria Shqiptare me Qeverinë Italiane për një marrëveshje që synon sjelljen e emigrantëve shqiptarë të cilët vuajnë dënimin në Itali, në qendrat e Gjadrit dhe Shëngjinit? 2. Nëse po negociohet për marrëveshjen e sipërpërmendur cilat janë kriteret dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje? 3. Sa është numri i të burgosurve në Itali?	01.04.2025	Kërkesë e deleguar të Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme.	E plotë	Pa tarifë
23	28.03.2025	Kërkesë për informacion për shtetasin F.Y. Gjatë vitit 2006, ka ushtruar veprimtarinë e legalizimit të dokumenteve para konsullore në Ministrinë e Jashtme, Drejtoria e Shërbimeve Parakonsullore. Gjatë kohës së punës shtetasi i është drejtuar me një letër ankesë Ministrit të Jashtëm të asaj kohe. Për nevoja të provueshmërisë së kësaj letër ankesë kërkohet dokumentacioni dhe informacioni si me poshtë: 1. Kopje të letër ankesës, të njehsuar me origjinalin, nëse e dispononi, si dhe kopje të regjistrit ku është shënuar protokollimi i saj.	14.04.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si vijon: Sipas skemës së Klasifikimit të Dokumentacionit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, miratuar me Urdhrin e Ministrit, nr. 80, datë 08.02.2018, konkretisht sipas pikës 13 të seksionit I, letra apo ankesa në drejtim të MEPJ, ruhen deri në 10 vjet pas marrjes së tyre. Në këtë rast letër ankesa e ka plotësuar këtë afat dhe ka kaluar në procesin e asgjësimit.	E plotë	Pa tarifë

		2. Përgjigjen përkatëse (nëse ka). 3. Nëse dokumentacioni i mësipërm nuk gjendet në arkivin Tuaj, kërkohet informacion mbi institucionin ku është arkivuar, si fleta e regjistrit ku është protokolluar ankesa ashtu dhe vetë letër – ankesa. 4. Kërkohet informacion nëse kanë punuar në Ministrinë e Jashtme shtetasit N.M. S.S. E.B. G.B. dhe N. Dh., si dhe çfarë funksionesh kanë patur në vitin 2006. A është përfshirë në fushën e kompetencave të tyre legalizimi i dokumenteve konsullore?				
24	07.04.2025	Kërkesë për informacion sipas faktit: Më 8 shtator 2022, në zbatim të urdhrin të qeverisë shqiptare, diplomatët iranianë u larguan nga Ambasada e Iranit në Tiranë dhe nga vendi, pas prishjes së marrëdhënieve diplomatike me këtë shtet. Vendim erdhi pas sulmit kibernetik ndaj institucioneve qeveritare, që sipas të dhënave të kohës edhe nga hetimet, dyshohej se sulmi ka ardhur nga Irani, tashmë vend jo mik me Shqipërinë. Për sa më sipër, kërkojmë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informacion për sa vijon:	14.04.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion ju bëjmë me dije si vijon: 1. A ka ndryshuar diçka në marrëdhëniet mes dy vendeve në rrafshin diplomatik por jo vetëm që nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike? Më 15 korrik 2022, Shqipëria u bë shënjestër e agresionit iranian përmes një sulmi masiv kibernetik në infrastrukturën digjitale për ta shkatërruar atë, për të paralizuar shërbimet publike dhe për të hakëruar të dhënat dhe komunikimet elektronike nga sistemet qeveritare. Vendi ynë i konsideroi këto sulme në kundërshtim me frymën dhe shkronjën e Konventës së Vjenës për	E plotë	Pa tarifë

		1. A ka ndryshuar diçka në marrëdhëniet mes dy vendeve në rrafshin diplomatik por jo vetëm që nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike? 2. Nëse po, çfarë, në çfarë fushash, kur dhe si është implementuar? 3. Cili është statusi aktual i muxhahedinëve që strehohen në Manëz në të ashtuquajturin "Kampi ASHRAF 3"? 4. Cili është roli i Shqipërisë në raport me banorët e këtij kampi dhe ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës? 5. Zëra pranë Gardës Revolucionare në Iran, 2 vite më parë, raportuan se liderët e grupimit muxhahedin MEK janë duke përgatitur ikjen nga Shqipëria dhe po përmbyllin detajet e fundit për t'u mirëpritur në Kanada, për sa më sipër, a ka patur afat marrëveshja për pranimin e Muxhahedinëve në Shqipëri? Nëse po, cilat kanë qenë afatet dhe nëse ky afat ka përfunduar, si është vepruar? 6. Si qëndron e vërteta mbi të dhëna që sugjerojnë se muxhahedinët e "ASHRAF 3", po përgatiten të largohen drejt Kanadasë? 7. Kush është statusi i	Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, duke u ngjitur në nivelin e një lufte kibernetike të nisur nga Republika Islamike e Iranit kundër Republikës së Shqipërisë. Nisur nga kjo situatë, në muajin shtator 2022, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë vendosi ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit, me efekt të menjëhershëm. Që nga ndërprerja e tyre marrëdhëniet dypalëshe me Iranin mbeten të ngrira dhe kjo situatë nuk ka ndonjë ndryshim edhe aktualisht. 3. Cili është statusi aktual i muxhahedinëve që strehohen në Manëz në të ashtuquajturin "Kampi ASHRAF 3"? Më 16 mars 2013, qeveria shqiptare bëri publik vendimin e saj për t'u siguruar strehim për arsye humanitare një numri personash me origjinë iraniane, anëtarë të MEK, të cilët ndodheshin në kampin irakian Ashraf. Qeveria shqiptare u angazhua për mikpritjen dhe krijimin e të gjitha kushteve të një akomodimi të sigurt në Shqipëri të anëtarëve të MEK-ut, në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe ligjet e vendit, si dhe një zgjidhje të qëndrueshme për këtë çështje humanitare, duke dëshmuar një shembull të bashkëpunimit ndërkombëtar, në emër të vlerave të jetës dhe të njerëzimit. Procesi i zhvendosjes së ish-banorëve të Ashrafit	
--	--	---	---	--

		muxhahedinëve aktualisht dhe pse nuk i janë rinovuar lejet e qëndrimit? A jeni njohur me këtë problem?		filloi në mesin e majit 2013 pas disa muaj përgatitjesh. UNHCR Tirana me mbështetjen e Përfaqësisë Rajonale të UNHCR-së në Evropën Jugore ka koordinuar të gjitha aspektet që lidhen me ardhjen dhe integrimin fillestar të grupit. Pavarësisht kapaciteteve të kufizuara logjistike, financiare dhe burimeve njerëzore dhe presionit të vazhdueshëm nga Irani, Shqipëria është kontribuuesi kryesor dhe më i madh në procesin e zhvendosjes së tyre. MEK u pranua në Shqipëri për sigurinë e tyre dhe gëzon mbrojtje humanitare. Autoritetet shqiptare kanë nënshkruar marrëveshje edhe me drejtuesit e MEK, ku ndër pikat kryesore ishte mos përfshirja e MEK në aktivitete të kundërligjshme gjatë qëndrimit në Shqipëri, si dhe mos përfshirje në aktivitete të paligjshme ndaj vendeve të treta. Sa i takon pyetjeve nr. 2, 4,5,6,7 MEPJ vlerëson se kërkesën për informacion duhet ta delegojë tek Ministria e Brendshme për trajtim të mëtejshëm.		
25	09.04.2025	Në vijim të komunikimit tonë dhe gjithnjë në mbështetje të nenit 3 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” vërej se përgjigjet tuaja nuk janë në përputhje me qëllimin dhe parimet e këtij ligji. Sikurse jam përpjekur të sqaroj dhe në komunikimin e fundit, kërkesat e mia kanë qenë konkrete dhe të tilla duhet të ishin edhe përgjigjet tuaja. Për fat të keq	24.04.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, të regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2025, me nr. rendor 27, ju bëjmë me dije si vijon: Së pari, saktësojmë se shkresa e Institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka pasur për objekt "rivlerësimin e kandidaturës së [emri] për postin e [funksioni]" -	E plotë	Pa tarifë

		përgjigjet tuaja nuk janë të tilla, ndoshta për faj të “strukturave përkatëse” atëherë, gjithnjë në bazë të ligjit të sipërcituar, më përcillni komunikimin që keni patur për këtë çështje me “strukturat përkatëse” dhe nëse ky komunikim ka qenë verbal të sqarohem se kush ka thënë çfarë.	citim që do të pasqyrohet saktësisht në përputhje me përmbajtjen e dokumentit përkatës të ardhur nga Presidenca. Në këtë kontekst, kur Institucioni i Presidentit kërkon "rivlerësimin e kandidaturës", ai i kërkon Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme të rishikojë vendimin fillestar të propozuar dhe të vlerësojë nëse kandidatura në fjalë vijon të jetë e përshtatshme, apo nëse është e nevojshme të paraqitet një emërim i ri. Ky proces zhvillohet në kuadër të kompetencave ligjore të ministrit përkatës, i cili, nëse vlerëson se ka vend për ndryshim, ushtron të drejtën e tij diskrecionale për të paraqitur një kandidaturë tjetër, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Në vijim të kësaj kërkesë, dhe në përputhje me dispozitat e neneve 14 dhe 26, pika 3, të Ligjit nr. 23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm", Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka ndërmarrë vendimarrjen për të propozuar një kandidaturë të re për postin e kreut të misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Hungari. Ky qëndrim është bërë i njohur edhe në përgjigjen tonë të datës 12.03.2025, në të cilën është nënvizuar se, sipas nenit 14 të Ligjit nr. 23/2015, Ministri ka përgjegjësinë për drejtimin e Shërbimit të Jashtëm,	
--	--	--	---	--

				përfshirë të drejtën për të propozuar kandidatura për pozitat drejtuese në misionet diplomatike (neni 26). Kjo kompetence ushtrohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe brenda kufijve të diskrecionit të lejuar me ligj. Për sa i përket shprehjes "strukturat përkatëse", saktësojmë se kjo referon organet dhe njësitë përbërëse të administratës publike, të cilat në përputhje me Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe me Ligjin nr. 23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm", përbejnë zinxhirin funksional të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve për emërimet në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë.		
26	23.04.2025	Unë A. Y., gjyqtar në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në zbatim të nenit 3 pika 13 dhe nenit 32 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", më ngarkohet detyrimi ligjor për të vërtetuar të ardhurat e personave të lidhur, ku bën pjesë edhe babai im, shtetasi F. Y., i datëlindjes 30.08.1951. Gjatë vitit 2006, (por edhe me herët), ai ka ushtruar veprimtarinë e legalizimit të dokumenteve parakonsullore në Ministrinë e Jashtme, Drejtoria e Shërbimeve Konsullore. Për nevoja të provueshmërisë së kësaj veprimtarie, - ju kërkoj	06.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si vijon: Lidhur me pyetjen e parë ju informojmë se procedura e ndjekur për legalizimin e dokumenteve, realizohej nga subjekti i interesuar ose me prokurë të posaçme nga përfaqësuesi ligjor, në të kundërt nuk i ofrohej shërbimi i legalizimit. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për periudhën 2001 – 2007 nuk rezulton të ketë pasur asnjë marrëdhënie kontraktuale/ punësimi/ shërbimi me z. F. Y. Sa i përket regjistrave për shitblerjen e pullave fiskale apo regjistrimin e blerësve për periudhën e kërkuar, sqarojmë se Ministria për Evropën dhe	E plotë	Pa tarifë

		dokumentacion dhe informacion si me poshtë: 1. A figuron emri i babait tim F. Y. në librat (regjistrat) e shitjes së pullave fiskale në Drejtorinë e Legalizimit të dokumenteve konsullore, për vitet 2001 - 2007? Nëse po - sa pulla fiskale ka blerë babai im, për këtë periudhë kohe dhe me çfarë çmimi për njësi? Po të jetë e mundur, - informacioni të ndahet vit për vit. 2. A figuron emri i babait tim F. Y. në librat (regjistrat) e mbajtura nga Drejtoria e legalizimit të dokumenteve konsullore, - për të dokumentuar dorëzuesit e dokumenteve që do legalizoheshin nga kjo Drejtori, për vitet 2001 - 2007? Nëse po, - sa dokumente ka dorëzuar babai im për t'u legalizuar në këtë drejtori, - për këtë periudhë kohore? Nëse është e mundur, informacioni te ndahet vit për vit. 3. Nëse dokumentacioni i mësipërm (regjistrat), nuk gjenden në arkivin tuaj, - kërkoj të më tregoni institucionin ku janë arkivuar, - e nëse janë asgjësuar, - ju kërkoj të më vini në dispozicion	Punët e Jashtme nuk administrojnë dokument të tillë, pasi është jashtë veprimtarisë së saj publike (nuk ka tregtuar ndonjëherë pulla fiskale për të tretët). Për pyetjen e dytë, gjithashtu sqarojmë se, në regjistrat e legalizimeve, nuk regjistrohet personi që sjell dokumentin për legalizim, por emri i personit të cilit do të legalizohet dokumenti. Së fundmi, në lidhje me pyetjen 4 sqarojmë se këto shtetas kanë qenë diplomat karriere, por që tashmë nuk janë pjesë e stafit të MEPJ.		
--	--	---	--	--	--

		procesverbalet që dokumentojnë asgjësimin e këtyre librave (regjistrave). 4. Kërkoj informacion nëse kanë punuar në institucionin tuaj shtetasit Naim Mandro (ose Mandri), Suzana Sulollari, Erlinda Baçi, Gazmend Barbullushi, Enver Hoxha dhe Niko Dhima- si dhe çfarë funksionesh kanë patur në vitet 2001-2007 këta shtetas? A është përfshirë në fushën e kompetencave të tyre, - legalizimi i dokumenteve konsullore? Lidhur me këtë pikë, ju jam drejtuar me kërkesë edhe më parë, - por në përgjigjen që më keni kthyer me email, - nuk më është dhënë asnjë përgjigje. Unë kam legjitimitet material për të kërkuar informacionin dhe dokumentacionin e mësipërm, pasi këtë legjitimitet ma japin nenet 3 pika 13 dhe 32 të ligjit 84/2016 (i ndryshuar). Meqenëse përgjigjen tuaj do ta përdor si element provues gjatë gjykimit të çështjes nr 9/2023 në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, - atëherë, - këtë email - po ia dërgoj me cc edhe kolegjit, në mënyrë që ky i fundit, - në eventualitetin e mos përgjigjes nga ana juaj, - ose - përgjigjes jo të plotë,				
--	--	---	--	--	--	--

		- të miratoje kërkesën time drejtuar kolegjit, - që sipas neneve 223 dhe 224 të kodit të procedurës civile, t'iu urdhërojë, - që të ma vini në dispozicion në mënyrë të plotë, dokumentacionin dhe informacionin e sipër kërkuar. Duke përfunduar, do t'ju kërkoja që përgjigjen të ma dërgoni edhe në rrugë elektronike por edhe në adresën time postare, - e konkretisht, "Qyteti Shkodër, rruga Palok Kurti, Pallati pranë Kishës së Freterve, sipër Bar Restorant Elita". Veç kësaj, - do t'iu kërkoja që përgjigjen tuaj t'ia përcillni me cc edhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën elektronike zyrtare të kolegjit, që tregohet në këtë email.				
27	28.04.2025	Kërkesë për ndihmë institucionale për plotësim të datës së përfundimit të punësimit për efekt pensioni vullnetar në Shqipëri, sipas faktit: “Unë jam një qytetar shqiptar me banim në SHBA momentalisht. Po hulumtoj për të nxjerrë një pension vullnetar në Shqipëri, për vitet e punës që kam plotësuar atje, duke shtuar edhe pagesa vullnetare për të plotësuar kohën minimale të punësimit (15 vjet) për kualifikim pensioni. Unë kam punuar në Shqipëri për rreth 9 vjet.	06.05.2025	Vënë në dispozicion përgjigja kërkuar.	E plotë	Pa tarifë

		Bashkëngjitur është dokumenti që ka lëshuar Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH – së, nëpërmjet e – Albania, lidhur me punësimin e personit tim në Shqipëri. Dokumenti bashkëlidhur e ka të munguar datën e përfundimit (largimit) të punës nga ana ime, në Ministrinë e Tregtisë së Jashtme. Por bazuar nga të dhëna të tjera, unë jam larguar nga Ministria në fjalë për studime në SHBA, në Maj 1995. Për dy vitet e studimeve mster në SHBA (1995 – 1997), Ministria e ruajti vendin e punës, sepse paguante përsëri rrogë të reduktuar 75% për mua (e tërhiqnin prindërit). Pra data e largimit nga puna nga Ministria duhet të rezultojë Dhjetor 1997 (muaji kur unë përfundova studimet për master në SHBA). Nuk e di pse dokumenti i nxjerrë nga Regjistri Themeltar i Ministrisë në fjalë, nuk e ka të saktësuar datën e përfundimit të punës në Ministri nga ana ime. Kërkoj me mirësi, të më ndihmoni me nxjerrjen e pagesave deri në ditën e fundit të punës në Ministrinë në fjalë. Për përcaktimin e datës së shkëputjes nga puna, datë e cila në dokumentin bashkëlidhur mungon.					
28	28.04.2025	Kërkesë për informacion sipas faktit: Quhem E. M – Sch. kam lindur në Tiranë dhe në	13.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj ju bëjmë me dije si vijon: Nga verifikimi i			

		vitin 2009 më është dashur të heq nënshtetësinë shqiptare pasi shteti gjerman nuk e lejonte dy nënshtetësinë në atë kohë. Nga qershori i 2024-ës është e mundur dy nënshtetësia në këtë shtet. Dëshira për të rifituar nënshtetësinë shqiptare për mua është e madhe dhe po me këtë dëshire nisa procedurën e organizimit të dokumentacionit. Kjo procedure është e gjatë dhe e lodhshme, pasi unë aktualisht jetoj ne Austri e me duhej te merrja dokumentacionin e duhur në të gjitha shtetet ku kam jetuar më parë. Ia dola me sukses dhe preva biletën për në Tiranë për t'iu drejtuar sportelit të Komisarariatit nr. 3 në Tiranë, nga i cili nis procedura e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm. Ndërkohe, në nëntor të vitit 2024 ka dalë një udhëzim i cili parashikon që personat, të cilët kanë lënë nënshtetësinë shqiptare dhe kanë fituar një nënshtetësi tjetër, dhe aplikojnë për rifitim të nënshtetësisë shqiptare duhet të dorëzojnë një certifikate lindje dhe familjare nga vendi ku kanë lindur dhe njëkohësisht nga vendi ku kanë fituar nënshtetësinë tjetër. Kjo pikë u bë pengesë për mua, pasi unë kam lindur në Shqipëri e jo në Gjermani. Familja ime trungun e ka në Shqipëri e jo në Gjermani. Pra këto certifikata unë mund t'i marr vetëm në	platformës SHKO rezultoi se keni aplikuar për shërbimin rifitim shtetësie me kod x, pranë Ambasadës sonë në Vjenë më datë 12 Maj 2025. Më datë 10.04.2025 me Udhëzimin e Përbashkët të MEPJ dhe MB nr. 69, lista e dokumentacionit për rifitimin e shtetësisë shqiptare është reduktuar dhe shtetasit duhet të ngarkojnë këto dokumente: 1. Kërkesa e të interesuarit drejtuar Presidentit të R.SH. 2. Certifikatë lindje nga akti/ personale në vendin e shtetësisë së huaj. 3. Certifikatë familjare marrë në vendin e shtetësisë së huaj. 4. Dëshmi penaliteti të lëshuar në vendin e shtetësisë tjetër ku aplikanti ka jetuar më shumë se gjashtë muaj (apostiluar/ legalizuar/ përkthyer) 5. Dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare (Dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë aktuale personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia). 6. Dokument i cili vërteton shtetësinë e huaj (pasaportë, kartë identiteti certifikatë natyralizmi/ personale ose vërtetim nga Bashkia/ Komuna). Ndërsa Konsulli duhet të sigurojë certifikatën nga akti i lindjes ose personale dhe dëshminë e penalitetit. Nga verifikimi i dokumentacionit që keni	
--	--	--	---	--

	shtetin shqiptar e jo në atë gjerman. Sikurse mund ta merri me mend, dorëzimi i dokumentacionit mu refuzua nga Komisariati nr. 3 ne Tiranë. Jam shumë e indinjuar, pasi mu tha si nga Komisariati nr. 3 dhe nga Drejtoria e Policisë së Tiranës që të rikthehem kur udhëzimi të jetë korrigjuar. Për mua rikthimi në sportelet e Tiranës është i lidhur me tre shtete te tjera ku duhet të mbledh sërish dokumentacionin, me kosto dhe me kohë. Nga ana tjetër kush më garanton se herën tjetër nuk del një mangësi tjetër në ligji bërje? Burimet e informacionit (Presidenca, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ambasadat, Ligji mbi nënshtetësinë dhe udhëzimet, të punësuarit nëpër institucione etj.) nuk informojnë saktësisht, website-et mbi procedurat dhe dokumentacionin përkatës nuk përditësohen dhe ti si qytetar duhet të sorrollatesh nga një zyrë tek tjetra, sepse interpretimet e udhëzimit janë nga më të ndryshmet. Në lidhje me këtë rast kërkoj një përgjigje zyrtare, të cilën duhet ta ndjek për të dorëzuar dokumentacionin përkatës. Këtë dokumentacion e disponoj, por mesa duket duhet ta ri mbledh, pasi derisa të dalë korrigjimi mbi udhëzimin e nëntorit të 2024-ës e vlefshmëria e tyre mbaron. Ju lutem të më kontaktoni		ngarkuar rezultoni mungesë e theksuar në plotësimin e kriterëve, sepse keni ngarkuar vetëm kërkesën drejtuar Presidentit, e cila i përket muajit shkurt 2025. Në faqen zyrtare të MEPJ në rubrikën SHKO gjendet informacioni i detajuar mbi dokumentacionin, formati i kërkesës dhe udhëzime të nevojshme.	
--	---	--	---	--

		me një zgjidhje dhe informacione të sakta në këtë adresë emaili.				
29	29.04.2025	Kërkesë në lidhje me adresën dhe kontaktin a Ambasadës së Belgjikës në Shqipëri.	30.04.2025	Kontakti për informacionin e kërkuar gjendet në linkun si më poshtë vijon: https://punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/February-27-2025-DIPLOMATIC-LIST.pdf	E plotë	Pa tarifë
30	05.05.2025	Kërkesë për informacion: 1. A ka paraqitur ministri kërkesë për leje vjetore apo pezullim nga detyra gjatë periudhës 11 prill – 10 maj 2025? Ju lutem të përcillni kopje të urdhrit apo shkresës përkatëse nëse ekziston? 2. Ju lutem dërgoni listën e urdhrave të shërbimit dhe dietave të miratuara për ministrin, shoferin dhe anëtarët e kabinetit të tij gjatë periudhës 11 prill – 10 maj 2025, për çdo dalje apo aktivitet të zhvilluar në zonën zgjedhore ku ai/ajo kandidon. 3. A është tërhequr paga për muajin prill 2025 nga ministri? Nëse po, në çfarë date është kryer pagesa?	14.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, ju bëjmë me dije si vijon: 1. Ministri nuk ka paraqitur kërkesë për leje vjetore për këtë periudhë. 2. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka kryer shërbime në zonën zgjedhore ku kandidon. Gjatë periudhës 11 prill – 10 maj 2025 ka kryer shërbime jashtë shtetit, si vijon: - Në datën 14 prill 2025, ka qenë me shërbim në Luksemburg, shoqëruar nga Këshilltari i tij; - Në datën 26 prill 2025, ka qenë me shërbim në Vatikan; - Në datën 08 maj 2025 ka qenë me shërbim në Poloni. 3. Pagesat e punonjësve të MEPJ kryen në përputhje me Udhëzimin Nr. 1 datë 21.05.2021 “Për formën, elementët dhe plotësimin e listë pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.	E plotë	Pa tarifë
31	08.05.2025	Unë P.P, shtetas shqiptare, po ju drejtohem me këtë kërkesë për informacion në lidhje me	14.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj ju bëjmë me dije si vijon: Pas kërtimeve të kryera në Arkivin e Ministrisë për	E plotë	Pa tarifë

		një ngjarje të ndodhur në Greqi më datë 19 maj 1996, ku sipas të dhënave që kam, babi im E.Ç. humbi jetën si pasojë e një përplasjeje me forcat e policisë greke. Duke qenë se nuk kam gjetur dokumentacion të plotë dhe të verifikuar mbi këtë ngjarje në burime publike, lutem të më vini në dispozicion çdo informacion zyrtar që Ministria mund të ketë lidhur me këtë rast, përfshirë kontaktimin e autoriteteve greke nëse është e nevojshme me qëllim orientimin tek institucioni përkatës në Greqi me të cilin mund të kontaktoj.		Evropën dhe Punët e Jashtme, si në dosjet që i përkasin marrëdhënieve me shtetin grek, ashtu dhe në dosjet e Drejtorisë Konsullore për vitin 1996, të cilat përmbajnë dokumentacion mbi problematikat e shtetasve shqiptarë në territorin grek gjatë asaj periudhe, nuk është konstatuar asnjë informacion ku të përmendet emri i shtetasit në fjalë. Shtojmë gjithashtu se, bazuar në skemën zyrtare të indeksimit dhe ekspertizës së dokumenteve të MEPJ, dokumentacioni konsullor që lidhet me mbrojtjen dhe asistencën konsullore ndaj shtetasve shqiptarë ka një afat ruajtje prej 15 vitesh. Dokumentacioni i kërkuar i takon vitit 1996 dhe, ndonëse ne kishim ende në dispozicion dosjet përkatëse, afati i ruajtjes së tyre është tejkaluar sipas normativës në fuqi.		
32	08.05.2025	Kërkesë për informacion sipas faktit: "I nderuar staf i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Shpresoj që ky mesazh t'ju gjejë mirë. Unë jam F.A, asistent lektore pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe kandidate për doktoraturë pranë Universitetit të Evropës Juglindore, Maqedoni e Veriut. Aktualisht jam duke përgatitur tezën doktrale me titull: "Migracioni drejt Bashkimit Evropian: Qeverisja e politikave migratore të Shqipërisë". Në kuadër të kërkimit,	23.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj ju bëjmë me dije si vijon: Personi i kontaktit, për të realizuar intervistën mbi politikat migratore shqiptare dhe mbështetjen ndaj diasporës, nga Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike, Kulture dhe Diasporës do të jetë znj. E. R. Gjithashtu gjeni bashkëlidhur një përmbledhje të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Diasporës. Për sa i përket trajtimit të "politikave migratore" duhet t'i drejtoheni Ministrisë së Brendshme si institucioni kompetent që udhëheq edhe Strategjinë Kombëtare të Migracionit.	E plotë	Pa tarifë

	kam realizuar një studim të gjerë përmes një ankete me 1021 migrantë shqiptarë në vendet e BE-së. Tashmë jam në fazën përfundimtare të punës shkencore dhe dëshiroj të përfshij edhe perspektivën institucionale përmes intervistave me përfaqësues të institucioneve përkatëse. Me këtë rast, do të isha shumë mirënjohëse nëse mund të më ndihmonit me identifikimin e kontakteve të duhura brenda Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ose në institucione të tjera përkatëse, për të realizuar 2-3 intervista të shkurtra mbi politikat migratore shqiptare dhe mbështetjen ndaj diasporës. Te dhënat do të përdoren vetëm për qëllime akademike, me ruajtje të plotë të etikës dhe anonimatit, nëse kërkohet. Për shkak të afateve të mbrojtjes së doktoraturës, intervistat do të ishte e dëshirueshme të realizoheshin brenda muajit maj. Në bashkëngjitje gjeni një përmbledhje të shkurtër të temës së doktoraturës, si dhe një kopje të pyetësorit të realizuar me migrantët shqiptarë në BE. Për ilustrim të punës kërkimore të realizuar, më lejoni të bashkëngjis po ashtu një pamje të shkurtër nga platforma SurveyMonkey, ku janë regjistruar përgjigjet e 1021 migrantëve shqiptarë që jetojnë në				
--	--	--	--	--	--

		BE.”				
33	14.05.2025	Kërkesë nga z. B.D. Universiteti Aleksandër Moisiu në vijim të komunikimit institucional me Azerbaijan State Oil Industry University, është në prag të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe eksplorimit të mundësive për diploma të përbashkëta, projekte të përbashkëta etj. Meqenëse është universiteti i parë nga Shqipëria që bën marrëveshje me universitetin në Azerbajxhan, kërkohet mendim n.q.s. jemi në përputhje me politikat dhe marrëdhëniet e shtetit shqiptar me këtë shtet, dhe nëse mund të procedohet me bashkëpunimin.	29.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion në lidhje me një marrëveshje bashkëpunimi me “Azerbaijan State Oil and Industry University”, ju bëjmë me dije si më poshtë: Marrëdhëniet mes vendit tonë dhe Republikës së Azerbajxhanit kanë njohur dinamikë intensive zhvillimesh në fusha me interes dypalësh dhe të dy vendet po punojnë për thellimin e tyre. Në këtë kuadër, shihet me interes në parim edhe bashkëpunimi në fushën e arsimit. Lidhur me rastin konkret, nisur nga rregullat dhe praktikat ekzistuese institucionale, duhet t’i drejtoheni Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, duke i parashtruar synimet që parashikon përmes marrëveshjes, ndër të tjera dhe diplomat e përbashkëta. Më tej Ministria e Arsimit dhe Sportit mund t’i drejtohet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për dhënie mendimi apo shqyrtim të mëtejshëm, sipas kompetencave të parashikuara.	E plotë	Pa tarifë
34	27.05.2025	Në adresën e emisionit “Stop” në Rtv Klan është denoncuar një rast specifik, Znj. Sh. B. të cilës i kanë marrë vajzën e saj 6 muajsh S.B. në kufirin që kalon Kroacinë në datën 17 maj 2025. Zonjës nuk i është dhënë asnjë informacion se pse po ja marrin vajzën 6 muajsh dhe për këtë arsye	29.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si vijon: Më datë 9 maj 2025, Ambasada e RSH në Zagreb është kontaktuar nga autoritetet policore kroate të Pikës së Kalimit Kufitar (PKK) të Karasovic (Prefektura Dubrovnik-Neretva), ku ishte paraqitur shtetasja shqiptare Sh. B., e	E plotë	Pa tarifë

		ne si emision kërkojmë informacion se ku ndodhet vajza 6 muajsh dhe a do t'i kthehet nënës?		datëlindjes 10/07/1984, vendlindja Dibër, shoqëruar nga vajza e saj M. L., e datëlindjes 18/05/2011, si dhe një fëmijë 6 muajsh, që nuk ishte regjistruar dhe kishte dokumente italiane. Të lartpërmendurit kishin deklaruar në PKK se ishin deportuar nga Franca dhe po udhëtonin për t'u kthyer në Shqipëri. Shtetësja Braja bashkë me fëmijët tentoi të kalonte në mënyrë të paligjshme kufirin, por u ndalua nga autoritetet policore kroate dhe u soll në PKK. Autoritetet policore kroate kontaktuan ambasadën duke kërkuar ndihmë pasi ata ishin në një gjendje të mjerueshme, pa mjete financiare. Gjithashtu, autoritetet policore informuan Ambasadën se nëna bashkë me foshnjën e mitur ishin diagnostikuar me një sëmundje të rëndë të transmetueshme, ndërsa vajza tjetër kishte probleme të shëndetit mendor. Autoritetet policore kroate kërkuar ndihmën e Ambasadës për të lëshuar dokumente udhëtimi për znj. B. dhe vajzën e saj L. për të vazhduar udhëtimin në Shqipëri, ndërsa foshnjën 6 muajsh e dërguan për kujdes shëndetësor të mëtejshëm pranë strukturave përkatëse. Duke vlerësuar rastin e paraqitur, si dhe në komunikim me autoritetet policore kroate, zyra konsullore e Ambasadës procedoi me lëshimin e lejeve të kalimit gratis.	
--	--	--	--	--	--

			Sqarojmë se leja e kalimit është lëshuar po atë ditë, ndërsa procedurat janë plotësuar nga zyra konsullore. Lejet e kalimit janë përcjellë në rrugë elektronike pasi dakordësuam me autoritetet policore kroate, për të bërë të mundur vijimin pa vonesa të udhëtimit për znj. B. dhe vajzën e saj (bashkëlidhur lejet e kalimit). Përsa i takon foshnjës 6 muajsh me initiale S. B., autoritetet kroate nuk e lejuan të vazhdonte udhëtimin pasi ishte në gjendje të keqe shëndetësore, nuk kishte dokumente udhëtimi dhe kishin dyshime për trafik fëmijësh. Sipas informacionit të policisë në PKK, për këtë foshnje kishte një vendim gjyqësor të dhënë në Itali që ndalonte nxjerrjen e foshnjës jashtë hapësirës Schengen, dhe duke qenë se kufiri kroat është kufiri i fundit i zonës Schengen, nuk u lejua që foshnja të vijonte udhëtimin. Autoritetet kroate informojnë se duhet të pengonin vetëm që foshnja të linte hapësirën Schengen, dhe për këtë arsye nëna u la e lirë të vijonte udhëtimin. Foshnja u dërgua për kujdes shëndetësor pranë shërbimeve përkatëse, duke informuar znj. Sh. B. për sa më lart dhe për mënyrën sesi të interesohej për fëmijën. Ambasada e RSH në Zagreb është interesuar lidhur me këtë rast, dhe thekson se informacioni për foshnje të marra nën	
--	--	--	--	--

			kujdes nga shërbimet përkatëse është vështirë të merret, duke pasur parasysh parimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së interesit të të miturit. Mësuam se foshnja aktualisht ndodhet në Split, Centar za pruzanje Usluga u Zajednici Maestral, Jurja Sizgorica 4, 21000, numër kontakti 0038521535400. Fëmija vijon të ketë kujdesin e nevojshëm nga autoritetet. Për të pasur më shumë informacion, duhet të kontaktohet Centar za Socijalnu skrb, Gunduliceva 25, 21 000, Split, tel: 0038521350600. Nga kontaktet që morëm me qendrën përkatëse përmes Konsullit tonë të Nderit në Dubrovnik (i cili është edhe avokat), u informuam se askush, përfshirë edhe Ambasadën, nuk ka të drejtë të kërkojë informacion për fëmijën, me përjashtim të personit apo institucionit që ka kujdestarinë e fëmijës, gjë e cila duhet të jetë përcaktuar në vendimin e dhënë nga autoritetet italiane. Na konfirmuan se deri më tani, askush nuk është interesuar për fëmijën. Autoritetet kroate kanë dëshirën dhe vullnetin për t'i dhënë zgjidhje këtij rasti dhe fëmija të jetë në kujdestarinë e autoritetit të përcaktuar nga gjykata (informalisht na thanë se është i kushtueshëm kujdesi për një foshnje që vuan nga një sëmundje e rëndë e transmetueshme), megjithatë, tashmë që	
--	--	--	--	--

				fëmija ndodhet në territorin kroat dhe nën kujdesin e shërbimeve përkatëse kroate, është një procedurë e caktuar për të bërë të mundur marrjen e fëmijës prej qendrës. Vendimi i dhënë në Itali për kujdestarinë e foshnjës duhet të njihet sipas procedurave përkatëse nga autoritetet kroate dhe më pas të vijohet me hapat për marrjen e fëmijës.		
35	28.05.2025	Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, emisioni Vetting kërkon si informacion: 1. Paketën e plotë (Paketën 1 dhe 2) të sanksioneve të miratuara nga Qeveria Shqiptare për bizneset ruse apo të lidhura me këto të fundit përsa i përket luftës në Ukrainë. 2. Listën e plotë të subjekteve dhe individëve që janë në listën e sanksioneve të miratuara nga Qeveria Shqiptare për luftën në Ukrainë. 3. Listën e plotë të subjekteve dhe individëve ndaj të cilëve janë marrë masa nga Qeveria Shqiptare për shkak të sanksioneve të miratuara që lidhen me luftën në Ukrainë.	09.06.2025	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si vijon: Qeveria shqiptare ka miratuar të gjitha vendimet e miratuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian, më lidhje me masat shtrënguese të vendosura nga Bashkimit Evropian në kontekstin e luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, konkretisht paketa 1 "Në lidhje me veprimet e Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë dhe paketa 2), "Në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainaset" cilat janë bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, në zbatim të ligjit nr. 72/2019 "Për Masat Shtrënguese Ndërkombëtare Në Republikën E Shqipërisë", i ndryshuar. Aktualisht janë miratuar 17 Paketa të masave shtrënguese që lidhen me paketat 1 dhe 2. Këto vendimet janë të publikuara në Qendrën për Botimet Zyrtare si dhe në Regjistrin Elektronik për Masat Shtrënguese	E plotë	Pa tarifë

				Ndërkombëtare, në faqen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që mund të aksesohet në linkun: https://arkiva.punetejashtme.gov.al/masat-shtrenguese-nderkombetare/. Gjithashtu, bëjmë me dije se lista e plotë e personave, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese të miratuara nga qeveria shqiptare për luftën në Ukrainë mund të gjendet në referencat e mësipërme, ku të gjitha vendimet përkatëse janë të publikuara në gjuhën angleze dhe përkthimin në gjuhën shqipe nga përkthyes i licencuar.		
36	04.06.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka dërguar në Parlament “Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” dhe në faqen zyrtare mbi këtë projektligj nuk përfshihet pika 3 në nenin 68, bashkëngjitur linku https://punetejashtme.gov.al/single-konsultimi/id=770 Në nenin 68 (pika 3) thuhet shprehimisht: “Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjithë diplomatët në shërbim duhet t’i nënshtrohen një testimi të detyrueshëm për të verifikuar aftësitë e tyre. Procedurat dhe kriteret e testimit do të përcaktohen	09.06.2025	Duke uruar të jeni mirë na lejoni fillimisht të përcjellim konsideratën tonë për çdo lloj forme gazetarie profesionale dhe të bazuar në fakte e burime. Si zyrë e koordinorit të informimit pranë MEPJ, kemi qenë gjithmonë të disponueshëm dhe vazhdojmë të jemi korrekt ndaj çdo kërkesë për informacion që vjen ndaj institucionit tonë. Në një artikull tuajin të publikuar më datë 03.06.2025 në faktoje.al në lidhje me projektligjin për “shërbimin e jashtëm”, keni dalë në përfundime duke paragjykuar, dhe pa kërkuar asnjë koment paraprak nga ana e institucionit tonë. Për ne, kjo nuk është aspak profesionale dhe me shumë keqardhje edhe shkrimi i publikuar është me nota të njëanshme. Prononcimin e kërkuar vetëm pasi jua kujtuam	E plotë	Pa tarifë

		me akt nënligjor. Dispozitat e kësaj pike do të zbatohen brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit”. Në rast miratimi i këtij projektligji a rrezikohet që diplomatët e karrierës të përjashtohen nga shërbimi diplomatik? 2. Në draftin e publikuar në faqen zyrtare të MEPJ pika 3 neni 68 nuk ekziston, ndërkohë që në Parlament ka mbërritur shtesa në nenin përkatës, linku përkatës. Përse nuk ka kaluar në konsultim publik kjo pikë pra pika 3 neni 68? Cili institucion apo grup pune e përfshiu në variantin final që ndodhet në Parlament për shqyrtim dhe miratim? Mbi çfarë argumenti është shkruar si pikë? Bashkëlidhur: A ka referencë ligjore përmbajtja e pikës 3 neni 68 i draftit që aktualisht aksesohet në faqen zyrtare të parlamentit? 3. Çfarë synohet me këtë projektligj dhe në rast miratimi (përfshirë edhe shtesën përkatëse, konkretisht pika 3 në nenin 68) cili institucion do të marrë në provim dhe vlerësojë diplomatët?		këtë “mangësi” (ndërkohë që shkrimi vazhdon edhe tani, po i njëjti i njëanshëm). Në përfundim, ritheksojmë edhe një herë vlerësimin ndaj çdo kërkesë që vjen në kohë në mënyrë profesionale dhe në respekt ndaj institucionit.		
36/1	10.06.2025	Duke Ju uruar të jeni mirë, në përgjigje të email it ju bëjmë me dije: Shkrimi i publikuar në	01.07.2025	Në vijim të kërkesës Tuaj ju bëjmë me dije si vijon: Sa i përket pikës 3 të nenit 68, testimi i parashikuar ka		

		Faktoje.al, dt. 03.06.2025 mbi projektligjin për "Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë", është i bazuar në burime parësore publike: 1- Në shkrim i jemi referuar të dhënave zyrtare të institucionit tuaj. Krahasoni i projektligjit të publikuar në MEPJ, me projektligjin e mbërritur në Parlament (për të cilin sërish në shkrim publikojmë linkun përkatës), rezultoi se nuk është i njëjtë. 2- Gjithashtu mbi thelbin e çështjes së ngritur citimi është i plotë, i projektligjit të mbërritur në Parlament, konkretisht pika 3 neni 68. Në reference të tij nuk ka asnjë shkurtim apo ndërhyrje, pasi citimi i nenit përkatës është i plotë. 3- Interpretimi që i bëjnë ekspertët një çështje të caktuar. Në përfundim lutemi të na dërgoni qëndrimin tuaj për ta pasqyruar në shkrim, mbi bazën e pyetjeve përkatëse në adresën zyrtare të institucionit me datë 04.06.2025.		për qëllim të realizojë një vlerësim profesional të diplomatëve në shërbim, me synimin për të rritur më tej standardet dhe efektivitetin e Shërbimit të Jashtëm. Ky do të shërbejë si një instrument për të identifikuar kapacitetet ekzistuese duke përfshirë edhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm profesional, në përputhje me performancën dhe nevojat institucionale. Procedurat dhe kriteret konkrete do të përcaktohen me akt nënligjor.		
37	16.06.2025	Bazuar në ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" lutem gjeni më poshtë kërkesën për informacion për mënyrën dhe masat e marra për zbatimin të akteve ligjore: VKM Nr. 173, datë 18.3.2022 "Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme	19.06.2025	Kërkesa ju është përcjellë institucioneve përgjegjëse. Me hyrjen në territorin e RSH, shtetasit e huaj trajtohen nga strukturat përkatëse të MB, DPPSH sa i përket statusit dhe MAS për kërkesat e tjera.	E plotë	Pa tarifë

		shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e Task-Forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuësve të mbrojtjes ndërkombëtare", i ndryshuar dhe VKM Nr. 169, datë 18.3.2022 "Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kërkesa për informacion vjen pasi, ky informacion, edhe pse bën pjesë në Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, sipas Nenit 7 të Ligjit Nr. 119/2014, pas konsultimit të informacionit publik në faqet web të Kryeministrise dhe ministrive të linjës, nuk rezulton i publikuar. 1. Në zbatim të pikave 3, 3/1, 3/2, 3/3, 3/4 të VKM Nr. 173, datë 18.3.2022, a i ka përfunduar mbrojtje e përkohshme në Republikën e Shqipërisë Shtetasit Ukrainas që kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë para datës 17.3.2024 2. Bazuar në VKM Nr. 169, datë 18.3.2022 dhe ligjit Nr. 79/2021 "Për të huajt" dhe VKM Nr. 173, datë 18.3.2022 dhe ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë",				
--	--	--	--	--	--	--

		Shtetasit Ukrainas të cilët hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë cilin regjim ligjore ndjekin? Për shembull, a kanë të drejtë shtetasit Ukrainas, që gjatë afatit katë vjeçar të përcaktuar në VKM VKM Nr. 169, datë 18.3.2022, të punojnë në Republikën e Shqipërisë? 3. Në zbatim të Pikës 5 e vijuese të VKM Nr. 173, datë 18.3.2022, dhe të Nenit 86 të Ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë" cilat janë masat e marra nga Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe Ministrinë e tjera për zbatimin e këtij vendimi? Konkretisht cilat janë masat e marrë, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore për të siguruar të drejtat e shtetasve Ukrainas me mbrojtje të përkohëshme për - për arsim para universitar në të njëjtat kushte me shtetasit shqiptarë; - për ndihmë juridike të garantuar nga shteti; - për punë dhe trajnime profesionale; Kërkesa për informacion i drejtohet Koordinatorit për të drejtën e informimit, në Kryeministri si institucion që përfaqëson Këshillin e				
--	--	--	--	--	--	--

		Ministrave që është institucion përgjegjës për aktet ligjore objekt kërkesë dhe Koordinatorit për të drejtën e informimit, në Ministrinë e linjës si institucion përgjegjës për marrjen e masave për zbatimin e akteve nënligjore të sipërcituara. Mbetem në dispozicionin tuaj për çdo kërkesë që mund të nevojitet për dhënien e informacionit në mënyrë të plotë dhe brenda afateve ligjore.				
38	16.06.2025	I nderuar staf i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Unë quhem F. K. dhe jam studente në programin Master për Marrëdhënie Ndërkombëtare pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë (FHF), Universiteti i Tiranës. Në kuadër të një kërkimi akademik, jam e interesuar të kem akses në dokumente arkivore të Ministrisë që lidhen me: Kontributet e Shqipërisë në NATO-s pas dhe para anëtarësimit, Sfidat dhe perspektivat e Shqipërisë brenda NATO-s Ju lutem të më vini në dispozicion materialet përkatëse, nëse është e mundur, në formë fizike ose elektronike, sipas procedurave të institucionit dhe legjislacionit përkatës.	16.06.2025	I është vënë në dispozicion përgjigja kërkuarës. I është krijuar akses për studim në institucion.	E plotë	Pa tarifë
39	18.06.2025	Po ju drejtohem me këtë email për të kërkuar më shumë informacion mbi	25.06.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, ju përcjellim përgjigjen si më	E plotë	Pa tarifë

		operacionin e evakuimit të pesë qytetarëve shqiptarë nga Izraeli, të cilët ndodhen të sigurt në Egjipt, siç jemi informuar. Do të doja të kuptoja më mirë procesin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar që u realizua për këtë evakuim. Konkretisht, do të doja të dinim: 1. Cilat ishin hapat konkretë që u ndërmorën për evakuimin dhe sa kohë zgjati ky proces? 2. Si u koordinua ky operacion mes ambasadave shqiptare në Tel Aviv dhe Kajro? 3. Çfarë masash u morën për të garantuar një evakuim të sigurt? Do të vlerësoja çdo informacion shtesë që mund të më ofroni mbi këtë çështje.		poshtë vijon: Procesi ka nisur me fillimin e konfliktit dhe organizimi është bere/behet sa me shpejt te jete e mundur. Qytetaret janë paraqitur/paraqiten ne Ambasade dhe kërkojnë asistence, ndërsa Ambasada fillimisht udhëzon për kushtet e sigurisë bazuar ne informacionet dhe udhëzimet zyrtare qe merr nga autoritetet vendore. Ne vartësi te kushteve te sigurisë ne vend, Ambasada ka pare/shikon mundësitë e daljes nga vendi (rruge detare, tokësore ose ajrore), mbështetur edhe numrin te qytetareve, Ambasada ne TLV ka vlerësuar/vlerëson mundësitë e organizimit te daljes dhe ne koordinim me MEPJ dhe Ambasadat tona ne vendet përmes te cilave do behet evakuimi, nisin procesin e evakuimit. 1. Ne rastin konkret, Ambasada ne TLV ka njoftuar/njofton emrat dhe te dhënat e qytetareve ne MEPJ dhe tek Ambasada jone ne Kairo ne mënyre qe te njoftohet kufiri dhe te asistohet me te gjitha nevojat. 2. Aktualisht kemi evakuuar me sukses te plotë dy grupe brenda 9 ditëve, operacion i zhvilluar ne bashkëpunim me te gjitha strukturat e mësipërme.		
40	19.06.2025	Ne jemi gazetarë nga Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe po punojmë rreth një artikulli	25.06.2025	Në përgjigje Tuajës bashkëlidhur ju përcjellim qëndrimin sipas kompetencës se institucionit.	E plotë	Pa tarifë

	që ka të bëjë me raportin e hartuar nga Komisioni Evropian më 15 Maj të Këtij viti. Gjatë shqyrtimit të raportit na kanë lindur disa pyetje për të cilat do të luteshim të kishim komentin tuaj në mënyrë që raportimi jonë të jetë sa më i saktë dhe afër së vërtetës. 1. Sipas raportit, Shqipëria po haset me disa problematika në fushën e Drejtësisë por edhe atë financiare. Konkretisht, citohet: "The investigation and arrest of an elected official, confirmed by the Specialised Structure against Organised Crime and Corruption (SPAK) Court in February 2025, triggered unprecedented public reactions by the executive and legislative branches, including attempts to put pressure on SPAK and judicial institutions. This raises serious concerns. SPAK published tão letters of complaint to the Ministry of Interior and the State Police for failure to reinforce security and ensure the safety of SPAK personnel during a protest outside SPAK premises. During the reporting period, six magistrates have been placed under protection, including tẽo judges and four prosecutors" - duke iu referuar protestës së mbështetësve të ish-Kryebashkiakut Veliaj më	Cili është komenti juaj për mënyrën se si mund të ndikojë në rrugën për integrimin në BE të kësaj pike të raportit? Qeveria shqiptare, me vullnet të palëkundur politik, është arkitektja e reformës në drejtësi, nisur në vitin 2014. Pjesë e kësaj reforme është rëndësia jetike që ka mbrojtja e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë. Në këtë kuptim, nuk ekziston asnjë ekuivok se organet e drejtësisë duhet të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë të sigurt, krejt të papenguar e jashtë çdo trysnie. Edhe në rastin konkret, qëndrimi politik i qeverisë shqiptare mbetet i qartë në mbështetje ndaj punës së SPAK. Ne e shohim sundimin e ligjit jo vetëm si një detyrim ndaj BE-së, por si një themel të shëndetshëm të demokracisë sonë. 2. Gjithashtu, në raport citohen problematikat në vakantet e trupit gjyqësor në sistemin e Drejtësisë, si dhe efica e punës së sistemit gjyqësor, e cila ndikohet negativisht për shkak të çështjeve të mbetura stok, që sipas raportit mbetet një çështje e pazgjidhur. Masa vendimtare për të rritur efica ende nuk janë ndërmarrë"- thuhet në raport ku theksohet se mungesa e burimeve njerëzore në sistemin e Drejtësisë, përfshirë magistratët duhet të	
--	--	---	--

	12 shkurt 2025. Protestë dhe akt kundra trupës gjyqësore që nuk u dënua nga përfaqësues së Qeverisë. Cili është komenti juaj për mënyrën se si mund të ndikojë në rrugën për integrimin në BE të kësaj pike të raportit? 2. Gjithashtu, në raport citohen problematikat në vakantet e trupit gjyqësor në sistemin e Drejtësisë, si dhe efica e punës së sistemit gjyqësor, e cila ndikohet negativisht për shkak të çështjeve të mbetura stok, që sipas raportit mbetet një çështje e pazgjidhur. "Masa vendimtare për të rritur efica ende nuk janë ndërmarrë"- thuhet në raport ku theksohet se mungesa e burimeve njerëzore në sistemin e Drejtësisë, përfshirë magjistratët duhet të trajtohet me prioritet. Në çfarë faze ndodhen bisedimet mes Shqipërisë dhe BE-së për çështjet e Drejtësisë? Cilat janë kushtet që Shqipëria duhet ende të plotësojë në këtë drejtim?	trajtohet me prioritet. Reforma në drejtësi është një nga sipërmarrjet më rrënjësore të ndërmarra nga Qeveria shqiptare me synim konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe përparimin e rrugës evropiane të Shqipërisë. Duke qenë se objektivi kryesor i kësaj reforme ishte efektiviteti dhe transparenca e organeve të gjyqësorit, si edhe rritja e besimit të publikut në to, procesi i vetingut ishte gjithëpërfshirës dhe meritokratik. Vetë rezultatet e verifikimit të trupës së gjykatësve dhe prokurorëve të cilët nuk kaluan testin e integritetit apo të aseteve të pajustificuara, ose të atyre që u dorëhoqën vullnetarisht dëshmojnë më së miri përmasën dhe rëndësinë e kësaj reforme. Kjo ishte edhe arsyeja që aktorë të caktuar e kundërshtuan apo i bënë rezistencë reformës në drejtësi. Është e pritshme që një proces i tillë katarsis të krijojë vakanca apo zgjatje kalendarike të dosjeve në shqyrtim. Pikërisht për këtë arsye, është punuar që të sigurohet në kohë të shpejtë një trupë e re magjistratësh dhe po vijohet me masa të tjera të specializuara për zgjidhjen e këtyre mangësive të përkohshme dhe mbarëvajtjen e plotë. Pas përfundimit të procesit rigoroz të verifikimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e shkallës së parë, masat kanë përforcuar integritetin, paanshmërinë dhe llogaridhënien gjyqësore.		
--	--	--	--	--

				Organet kryesore të qeverisjes - Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë -kanë mbikëqyrje të përmirësuar, ndërsa Dhoma e Posaçme e Apelit siguron proces të rregullt ligjor deri në vitin 2026. Futja në përdorim e Sistemit të Informacionit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS) të ndërveprueshëm me BE-në, së bashku me Strategjinë e Reformës në Drejtësi 2024-2030, nënvizon angazhimin e Shqipërisë për transparencë, pavarësi gjyqësore dhe përputhshmëri me standardet evropiane. Në çfarë faze ndodhen bisedimet mes Shqipërisë dhe BE-së për çështjet e Drejtësisë? Cilat janë kushtet që Shqipëria duhet ende të plotësojë në këtë drejtim? Vlerësojmë se Përgjigjen duhet ta formulojë Zyra e Kryenegociatorit, ose Ministria e Drejtësisë që drejtojnë negociatat për grupkapitullin "Themeloret" dhe kanë informacionet e nevojshme.		
41	19.06.2025	Në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, kërkoj të informohem për sa më poshtë vijon: 1- A ka kërkuar Shqipëria largimin nga vendi për shtetas turq apo të kombësive të tjera për persona te pretenduar nga ana e shtetit turk si pjesë	02.07.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, ju bëjmë, me dije si më poshtë vijon: Në lidhje me informacionin që kërkonti, bazuar në ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, në nenin 17, pika 2, germa “ë”, ju informojmë se e drejta e	E plotë	Pa tarifë

		të organizatës së Fetullah Gulen? 2- A ju ka vendosur në dispozicion Turqia ndonjë listë me emra të dyshuar prej tyre si pjesë e organizatës së Feto-s? 3- Nëse po, për sa prej tyre është kërkuar që të largohen nga Shqipëria? Në cilat periudha ka ndodhur kjo? 4- Presidenti Erdogan dhe ministri i jashtëm turk ka kërkuar disa herë nga Shqipëria që të ndërmarrë masa për të goditur institucionet e ndryshme private në Shqipëri si të lidhura me Feto. Cila ka qenë përgjigja nga ana Shqipërisë?		informimit kufizohet në këtë rast. Në vlerësim të MEPJ, ky kufizim është i nevojshëm për të mbrojtur interesat shtetërore dhe për të ruajtur stabilitetin dhe besueshmërinë në komunikimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve, si dhe në marrëdhëniet diplomatike me vendet e tjera.		
42	24.06.2025	Unë jam A. R., Drejtor Ekzekutiv i Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve", një organizatë e themeluar në vitin 2018 me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Në muajin tetor të këtij viti, organizata jonë planifikon të zhvillojë një event global në Shqipëri, në bashkëpunim me rrjetin ndërkombëtar MenEngage Alliance me qendër në Washington D.C. Ky aktivitet ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e barazisë gjinore, dhe do të mbledhë përfaqësues të organizatave partnere nga vende të ndryshme të botës. Aktualisht, jemi në fazën përgatitore dhe kemi	24.06.2025	Në vijim të kërkesës Tuaj, ju bëjmë me dije se në faqen zyrtare të MEPJ është publikuar regjimi i vizave për shtetasit e huaj, i cili është në shqip dhe në anglisht. Lidhur me pajisjen me vizë të shtetasve të huaj, ju bëjmë me dije se aplikimi për vizë kryhet vetëm online në link: https://e-visa.al/apply ku do të gjeni informacionin e detajuar, udhëzimet, tarifën e vizës për secilin shtet, si dhe formatin zyrtar të ftesës.	E plotë	Pa tarifë

		nevojë për informacion te sakte dhe te përditësuar ne lidhje me regjimin e vizave për shtetasit e huaj që do te marrin pjesë ne këtë aktivitet. Pasi kemi konsultuar faqen zyrtare te Ministrisë se Punëve te Jashtme, kemi hasur disa mospërputhje midis te dhënave te publikuara dhe informacionit te dërguar nga vete pjesëmarrësit. Ne këtë kuadër, do t'ju luteshim te na asistonit me një liste zyrtare te shteteve për te cilat kërkohet pajisja me vize për te hyre ne Republikën e Shqipërisë. Kjo do te na mundësoje te nisim pa vonese procesin e aplikimit online për vizë për pjesëmarrësit përkatës. Më poshtë po ndajmë listën e shteteve nga te cilat do te vijjnë pjesëmarrësit tanë, për te cilët kemi nevojë për konfirmim mbi regjimin përkatës te hyrjes në Shqipëri.				
43	27.06.2025	Ju shkruaj për të vendosur në vëmendjen tuaj një shqetësim lidhur me aplikimin për vizë turistike të znj. V. B. dhe vajzës së saj të mitur M. K. Aplikimet për vizë turistike të cilave u referohem mbajnë numrat e mëposhtëm të referencës: V. B. - CAI-240425070433448317; M. K. - CAI-240425070418448325. Ju drejtohem për t'ju	02.07.2025	Në përgjigje Tuajës, riaplikimet janë miratuar ditën e djeshme, nga strukturat dhe po dje janë gjeneruar dhe lëshuar vizat. Nga ana jonë nuk ka pasur asnjë vonesë, përkundrazi vlerësuam pozitivisht apelimin e refuzimit të vizave.	E plotë	Pa tarifë

	kërkuar të më ndihmoni në respektimin e së drejtës ligjore për të marrë informacion lidhur me procedurën dhe sidomos sepse rezultati pozitiv apo negativ qoftë i këtyre aplikimeve për vizë është shtyrë përtej çdo kufiri kohor të ligjshëm. Dëshiroj t'ju informoj këtu se aplikimet për vizë janë dorëzuar dhe pranuar si aplikimi nga ana e Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, Ministria për Punët e Jashtme dhe Evropën, më datën 24 prill, dhe më datën 24 maj, një muaj nga momenti i aplikimit janë refuzuar pa një arsye të qenësishme, me justifikimin se "mungonte ftesa nga ana e ftuesit" ndërkohë që me aplikimin ishte dorëzuar një deklaratë noteriale nga ana e z. J. J., si ftues i tyre në Shqipëri, për vizitën turistike, dhe si një shtetas i një vendi anëtar të Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi shqiptare. Pasi u plotësua edhe kërkesa për ftesë, në formatin e vizës së Tipit D., ndërkohë që i njëjti format nuk vlen për Tipin C të vizës, pasi nuk kërkohet në formularin e aplikimit në portalin e-visa, nuk kemi marrë më përgjigje për statusin e aplikimit. Ju lutem, më lejoni të citoj këtu nenin 24, pika 3 lidhur me shqyrtimin dhe lëshimin e vizës nga autoritetet kompetente,				
--	---	--	--	--	--

sipas Ligjit Nr. 79/2021 "Për të huajt ku shprehet mëse qartësisht se "Procedura totale e vlerësimit të kërkesës për vizë zgjat jo më shumë se 15 ditë nga data e pranimit të aplikimit për vizë. Në raste përjashtimore, ky afat mund të shtyhet me vendim të arsyetuar deri në 30 ditë, ky afat tashmë ka kaluar. Këtu i referohem edhe afatit 15 ditor, edhe atij 30 ditor. Me mirësjellje, ju kërkoj të llogarisni se kanë kaluar tashmë 2 muaj nga momenti i aplikimit, ndërkohë që aplikantët kanë blerë edhe biletat e ardhjes dhe ikjes nga Shqipëria, dhe janë detyruar tashmë të shtyjnë për herë të tretë këto bileta.

Në shtesë të sa më lart, kini parasysh se bëhet fjalë për një nënë të re me fëmijën e mitur, të cilat kanë si synim të vijnë për një vizitë turistike dhe për të takuar të afërmin e tyre, shtetas gjerman me leje qëndrimi për punësim në Shqipëri, dhe se për shkak të këtij bllokimi kaq të gjatë e të pashpjegueshëm në procedura, kjo situatë po ndikon në mirëqenien e tyre ekonomike dhe familjare.

Mbetemi në dispozicionin tuaj, për t'ju ofruar çfarëdo të dhëne apo dokumenti tjetër që mund t'ju duhet për t'ju lehtësuar procedurën, duke shpresuar se kjo pengesë e paarsyeshme do të zhduket së shpejti me

		ndihmën tuaj.				
44	27.06.2025	Jam duke kryer një kërkim personal dhe historik ne lidhje me stërgjyshen time, e cila gjatë periudhës së regjimit komunist ne Shqipëri ka pasur kontakte me te afërm te saj që jetonin në Republikën e Turqisë. Duke qene se ne atë kohe korrespondenca ndërkombëtare dhe marrëdhëniet me shtetas jashtë vendit kanë qenë të ndjeshme dhe të monitoruara, ju drejtohem me respekt për të pyetur nise ekziston mundësia që dokumentacioni apo letërkëmbime të tilla të jenë arkivuar në institucionin tuaj, konkretisht në Arkivin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (ndoshta tek pjesa e dosjeve të Shoqërisë Komisionare). Në këtë kuadër, do të isha mirënjohës nëse mund të me informoni mbi: 1. Procedurën për të kërkuar akses apo për të kryer një kërkim në arkivin tuaj. 2. Nëse kërkesa duhet të paraqitet përmes një shkrese zyrtare, kujt sektori apo drejtorie brenda ministrisë duhet t'i drejtohem? 3. Nëse ekziston ndonjë formular specifik që duhet plotësuar apo dokumentacion që duhet bashkëngjitur (siç mund të jenë dokumente identifikimi apo prova	01.07.2025	I është vënë informacioni në dispozicion. Mund të paraqitet në ditët në vijim pranë Arkivit për të parë dosjet që i interesojnë.	E plotë	Pa tarifë

		lidhjeje familjare). Do të isha shumë falënderues për çdo informacion orientues që mund të më vini në dispozicion, si dhe për një kontakt të drejtpërdrejtë institucional nëse është e mundur.				
45	25/07/2025	Duke qene se jemi duke kryer nje hulumtim gazetaresk, do na duheshin disa te dhena lidhur me listen e entiteteve ruse apo edhe individeve rus qe jane sanksionuar nga Shqiperia.	07/08/2025	I është vënë në dispozicion informacioni.	E plotë	Pa tarifë
46	28/07/2025	1. A i ka hapur Shqipëria të gjithë grup-kapitujt e negociatave me BE-në? 2. Cilet janë grupkapitujt e hapur deri tani nga Shqipëria dhe kur jane hapur ato?	07/08/2025	1. A i ka hapur Shqipëria të gjithë grup-kapitujt e negociatave me BE-në? Në vitin 2009, Shqipëria paraqiti kërkesën e saj zyrtare për anëtarësim në BE. Katër vjet më vonë, në qershor 2014, BE-ja i dha Shqipërisë statusin e kandidatit. Në vitin 2020, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e pranimit. Në korrik 2022, u mbajt Konferenca e parë Ndërqeveritare mbi negociatat e pranimit me Shqipërinë dhe Komisioni filloi procesin e screening. Në korrik 2023, Komisioni Evropian i paraqiti Këshillit raportin e shqyrtimit mbi Grup-Kapitullin 1 - Themelorët, duke përfshirë edhe standardet për hapjen e negociatave të pranimit në këtë grup-kapitull. 2. Cilet janë grupkapitujt e hapur deri tani nga	E plotë	Pa tarifë

			Shqipëria dhe kur jane hapur ato? Më 15 tetor 2024, Shqipëria hapi Grup- Kapitullin 1: Themelorët, duke përfshirë fushat dhe kapitujt e mëposhtëm negociues: Funksionimi i institucioneve demokratike, Reforma e administratës publike, Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore, Kapitulli 24 - Drejhtësia, liria dhe siguria, Kriteret ekonomike, Kapitulli 5 - Prokurimi publik, Kapitulli 18 - Statistikat, Kapitulli 32 - Kontrolli financiar. Më pas, më 17 dhjetor 2024, në Konferencën e tretë të Anëtarësimit, u hap Grup- Kapitulli 6: Marrëdhëniet e Jashtme, duke përfshirë kapitujt negociues: Kapitulli 30 -Marrëdhëniet e Jashtme dhe Kapitulli 31 - Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes. Kjo u pasua nga takimi I katërt i Konferencës së Anëtarësimit me Shqipërinë në nivel ministrior, i cili u mbajt më 14 prill 2025 në Luksemburg. Takimi shërbeu për të hapur negociatat me Shqipërinë mbi Grup- Kapitullin 2: Tregu i Brendshëm, duke përfshirë kapitujt negociues: Kapitulli 1 - Lëvizja e lirë e mallrave, Kapitulli 2 - Liria e lëvizjes së punëtorëve, Kapitulli 3 – E drejta e vendosjes dhe liria për të		
--	--	--	--	--	--

				ofruar shërbime, Kapitulli 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit, Kapitulli 6 - E drejta e shoqërive tregtare, Kapitulli 7 - E drejta e pronësisë intelektuale, Kapitulli 8 - Politika e konkurrencës, Kapitulli 9 Shërbimet financiare, Kapitulli 28 - Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit. Më pas, më 22 maj 2025, u mbajt në Bruksel takimi i pestë i Konferencës së Anëtarësimit me Shqipërinë. Po ashtu, ky takim shërbeu për të hapur negociatat me Shqipërinë mbi Grup-Kapitullin 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse. Ky grup përfshin: Kapitulli 10 - Transformimi digjital dhe media, Kapitulli 16 - Taksimi, Kapitulli 17 - Politika ekonomike dhe monetare, Kapitulli 19 - Politika sociale dhe punësimi, Kapitulli 20 - Politika e ndërmarrjeve dhe industrisë, Kapitulli 25 - Shkenca dhe kërkimi, Kapitulli 26 - Arsimi dhe kultura, dhe Kapitulli 29 - Bashkimi doganor. Kështu, deri më tani Shqipëria ka hapur katër nga gjashtë grup-kapitujt		
47	02/09/2025	Më datë 28 gusht, disa tifozë të ekipit sportiv Jagellonia, të pranishëm në Tiranë për të ndjekur ndeshjen e skuadrës së tyre, kanë dëmtuar shtatoren e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Në këtë kuadër, kërkoj informacion nëse Ministria	12/09/2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ju informojmë se autoritetet e policisë së shtetit janë duke ndjekur procedurat hetimore për zbardhjen e ngjarjes dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve që kryen dhunimin e monumentit të Heroit Kombëtar në sheshin	E plotë	Pa tarifë

		për Punët e Jashtme dhe Europën ka ndërmarrë ndonjë masë apo veprim zyrtar lidhur me këtë akt.		kryesor të kryeqytetit identifikimin dhe kapjen e autorëve. Nderkohe MEPJ ka percjelle indinjatën për aktet e ndodhura pranë ambasadës polake në Tirane.		
48	08/09/2025	GHF <u>has recently said</u> that the foundation is funded, in part, by a European country and/or countries, but has declined to say which so we are checking with each one. My question: Is Albania funding GHF or channelling money to GHF from another party?	08/09/2025	Albania is not providing nor channeling any funding to GHF from other sources.	E plotë	Pa tarifë
49	2/10/2025	Bazuar në të drejtën kushtetuese e veçanërisht në nenin 23 të saj e cila përcakton të drejtën e informimit si një akses i garantuar nga veprimtaria e organeve shtetërore, si dhe në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkoj nga ju për arsye studimore një informacion në lidhje me : 1-Cili është qëndrimi diplomatik i MEPJ për çështjen çame , një çështje e dhunimit flagrant të të drejtave të njeriut, e genocidit të ushtruar nga focat zerviste më 27 qershor 1944, datë e cila njihet si e tillë nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7839/30.06.1994?	17/10/2025	Ne e konsiderojmë Çështjen Çame si një çështje të të drejtave të njeriut dhe më saktë të të drejtave të individëve për lëvizjen e lirë, pronësinë, kujtesën dhe respektin për paraardhësit. Qeveria shqiptare e ka mbështetur kërkesën e kahershme të këtij komuniteti për të lëvizur lirshëm në Greqi dhe për të vizituar vendet e origjinës, për të vizituar varret e të parëve dhe për të pretenduar në mënyrë ligjore pronat e tyre. Në çdo rast dhe në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe, ne kemi bërë të qartë konceptin tonë mbi çështjen çame si një çështje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në shekullin 21, si një nga çështjet që pret një zgjidhje. Ashtu siç edhe parashikohet nga detyrimet që rrjedhin nga rezoluta e Kuvendit,	E plotë	Pa tarifë

	2-Cili është qëndrimi diplomatik i MEPJ për çështjen çame në raport me Kushtetutën e Shqipërisë si një akt themelor që obligon institucionet e Shqipërisë për të mbrojtur shtetasit dhe në raport me Rezolutën për zgjidhjen e çështjes çame të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2004 dhe të hyrë në fuqi në vitin 2013? 3-Cili është institucioni, organi, shteti, apo instancat e fundit ndërkombëtare që u është adresuar rezoluta e lartpërmendur për zgjidhjen e çështjes çame, detyrë kjo kushtetuese, ligjore dhe e integritetit kombëtar? 4-Si qëndron çështja çame në raport me aspiratën shqiptare për anëtarësim në Bashkimin Evropian ? 5-Kur i është adresuar për herë të fundit Greqisë në tryezën diplomatike zgjidhja e kësaj çështje dhe cilat kanë qenë propozimet e palës shqiptare përballë palës greke e cila refuzon të njohi një problem të tillë në marrëdhëniet tona diplomatike	pala shqiptare ka theksuar gjatë bisedimeve se sekuestrimi i pronave të popullsisë çame si kolaboracionistë të nazistëve është i padrejtë, se është vendim i marrë kundrejt një grupi të madh njerëzish, por jo mbi bazat e përgjegjësisë personale si kolaboracionistë. Çështja në fjalë është çështje e përgjegjësisë individuale dhe jo e dënimit kolektiv dhe si i tillë duhet të zgjidhet në frymën e praktikave evropiane, duke lejuar historianët dhe ekspertët e fushave të punojnë së bashku në një përpjekje për të hedhur dritë mbi atë që ka ndodhur në të kaluarën. Shqipëria dhe Greqia janë shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe kështu janë të detyruar të ndjekin legjislacionin ndërkombëtar përkatës dhe parimet kryesore në fushën e të drejtave të pronësisë dhe lëvizjes që rrjedhin nga Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Në kuadër të gjetjes së një zgjidhjeje për këtë çështje, pala shqiptare ka konfirmuar angazhimin e saj ndaj paprekshmërisë së kufijve dhe integritetit territorial, siç parashikohet nga Karta e OKB-së, Akti Final i Helsinkit, Protokollet e Firences dhe të gjitha aktet e tjera dhe normat ndërkombëtare. Në përfundim, çështja çame do të mbetet pjesë e		
--	---	--	--	--

				axhendës sonë dhe do të ngrihet në vazhdimësi për të gjetur zgjidhjen e duhur.		
50	23/10/2025	What is the number of Afghan refugees who are in the process of obtaining U.S. visas and are currently waiting in Albania?	04/11/2025	Shqipëria ishte vendi i pare që iu bashkua thirrjes së SHBA për të pritur shtetas afgane të cilet rrezikonin jetën pas ardhjes së talebanëve ne fuqi duke iu ofruar mbështetje, strehim, trajtim në një periudhe tranzitore përpara tërheqjes se tyre nëpermjet programit SIV ne SHBA. Nga viti 2021 dhe deri 2025 në vend erdhen të ndarë në faza disa mijera shtetas afgane të moshave dhe profesioneve te ndryshme, te cileve iu sigurua jetesa e nevojshme në bashkëpunim edhe me autoritetet amerikane me të cilet u arrit nje marreveshje bashkepunimi, afati i së ciles perfundoi ne mars 2025. Tashme sipas te dhenave të autoriteteve përgjegjese në Shqipëri kanë mbetur shume pak shtetas afgane në pritje të pajisjes me SIV (special immigration visa) dhe të përmbylljes përfundimisht të marrëveshjes.	E plotë	Pa tarifë

51	03/12/2025	Informacion nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Brazil për vrasjen e Alban Gropçaj në Brazil?	12/12/2025	A ka dijeni Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Brazil për vrasjen e z. Gropçaj? Ambasada ka pasur dijeni dhe është angazhuar për të ndihmuar familjarët, menjëherë pasi ndodhi tragjedia. Në këtë kontekst, gjatë periudhës shkurt-mars 2019, Ambasada ka zhvilluar një sërë komunikimesh me familjarët, me autoritetet braziliane, po ashtu edhe me avokatin e të ndjerit, në mënyrë që brenda kompetencave të lejuara nga konventat ndërkombëtare, të jepte ndihmën maksimale. 2 Cilat janë hapat e Ambasades për të marrë shpjegime Janë zhvilluar komunikime me MPJ braziliane, Policinë e Shtetit Ceará (njësia federative ku ndodhi vrasja) dhe njërin nga avokatët mbrojtës. Në fazën aktuale Ambasada ka kërkuar informacion zyrtar nga autoritetet braziliane për stadin aktual të procesit gjyqësor dhe pret ende një përgjigje prej tyre. 3 A ka Ambasada Brazil një raport zyrtar për vrasjen e shtetasit shqiptar? Me kërkesën e Ambasadës është dërguar raport zyrtar nga Policia e shtetit Ceará, (bashkëlidhur) gjithsesi në raport nuk jepeshin hollësi, pasi çështja ishte në hetim. Në këtë raport policia e Ceará njoftonte Ambasadën se, organet ligj zbatuese të atij shteti, kishin ndaluar shtetasin italian Guido Bertola. 4 A është kontaktuar Ambasada Brazil nga	E plotë	Pa tarifë
----	------------	--	------------	---	---------	-----------

			familjaret e shietasit Alban Gropçaj? Në periudhën shkurt-mars 2019 janë zhvilluar komunikime intensive ndermjet Ambasadës dhe familjarëve lidhur me procedurat perkatëse, perfshire pajisjen me disa dokumente të nevojshme si p.sh, pasaporta, certifikata e lindjes, deshmia e penalitetit, etj. Pas identifikimit perkatës, Ambasada lëshoi lejen për transportin e trupit (LTT) të të ndjerit, gjë që përbën detyrim ligjor për çdo shtetas shqiptar që humb jeten jashte vendit. Gjatë viteve të fundit, familjarët e të ndjerit Alban Gropçaj nuk e kanë kontaktuar asnjëherë perfagesinë shaiptare në Brazilia. Ndërsa procesi gjyqësor zhvillohet në Caucaia të shtetit Ceará, sqarojme se Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (1961) i ndalon diplomatet e huaj të nderhyjne në çështjet e brendshme të shtetit prites, ndërsa Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (1963) përcakton se angazhimi i zyrtarëve konsullorë në mbrojtje të bashkeshtetasve duhet të zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor-administrativ të shtetit prites.		
--	--	--	---	--	--

				Ne rastin konkret, dispozitat per pavarësinë e grygësorit duhet të respektohen si nga konsujt e huaj ashtu edhe nga institucionet braziliane.		
--	--	--	--	--	--	--

52	27/11/2025	Do ju lutesha te me ndihmonit me informacion lidhur me numrin e afganeve, te cilet ndodhen ende ne Shqiperi. Ky infomacion do te na ndihmonte per te pasur nje raportim korrekt per audiencen tone.	05/12/2025	Deleguar tek Ministria e Brendshme.	E plotë	Pa tarifë
----	------------	---	------------	-------------------------------------	---------	-----------

53	11/12/2025	Informacion për vendosjen në dispozicion të kriterëve që Bashkimi European ka vendosur për vendin tonë, ne kuader të procesit të antarësesimit, në fushën e mjedisit?	12/12/2026	Deleguar tek Ministria e Mjedisit.	E plotë	Pa trajfPa traifë
----	------------	---	------------	------------------------------------	---------	-------------------

54	23/12/2025	Sa është numri i aplikimeve për viza studentore në IAL-të shqiptare në 6 (gjashtë) vitet e fundit,si dhe shpërndarja e tyre për secilin vit (2020. 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025); 2. Sa është numri i vizave studentore të lëshuara (të miratuara) nga Shqipëria në 6 (gjashtë) vitet e fundit,si dhe shpërndarja e tyre për secilin vit (2020. 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025);	23/12/2025	Në vijim të kërkesës tuaj bëjmë me dije se numri total i lëshimit të vizave për studentë që vijnë nga vende qe kane nevojë për vizë në harkun kohor 2020-2025 (pasi sistemi i jep ne total dhe i ndan sipas shtetesive, jo viteve) është 652. Vihet re një tendence në rritje dy vitet e fundit.	E plotë	Pa tarifë
----	------------	--	------------	---	---------	-----------

55	16/12/2025	Në këtë kuadër, bazuar në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në VKM-në Nr.621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, si dhe VKM-në Nr. 252, datë 2.5.2025 “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësi e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipasparashikimeve të marrëveshjes së facilitetit, ratifikuar me ligjin nr.19/2025, do të vlerësonim shumë nëse do të na mundësonit informacion lidhur me: 1. Hapat, ecurinë e zbatimit të reformave/steps, dhe evidencat që provojnë progresin e raportuar, që ipërkasin periudhës zbatuese korrik - dhjetor 2025, ku përgjegjëse është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. 2. Përditësimin mbi progresin (nësa ka) të masave të konsideruara të pa-përmbushura nga vlerësimi zyrtar i Komisionit Evropian dhe që i përkasin periudhës tetor 2024-qershor 2025	30/12/2025	Në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është listuar institucion përgjegjës (së bashku me Ministrinë e Brendshme) për masën 5.7.1 "Përafrimi i kërkesave për lëshimin e vizave me standardet evropiane", ku hapat e përcaktuar përfshijnë përfundimin e regjimeve pa viza me të paktën dy vende në 2025 dhe me të paktën nga një vend në secilin nga vitet, 2026 dhe 2027, nga lista e vendeve për të cilat kërkohen viza për në Bashkimin Evropian (e matur në fund të çdo viti, në Dhjetor 2025, Dhjetor 2026 dhe Dhjetor 2027). Për vitin 2025, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka realizuar hapin e parë të masës duke hequr regjimin e lirë të vizave me dy shtete, përkatësisht Bahrejin dhe Bjellorusinë. Me VKM 236, datë 24.04.2025 "Për pezullimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bjellorusisë, për heqjen reciproke të kërkesave për vizë", Shqipëria ka pezulluar marrëveshjen me Bjellorusinë. Për shkak të dispozitave të përcaktuara në marrëveshjen në fjalë, lidhur me pezullimin e saj, ky pezullim ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2025. Ndërkaq, me VKM 209, datë 09.04.2025, "Për një ndryshim në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e	E plotë	Pa tarifë
----	------------	--	------------	---	---------	-----------

			kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, Bahrejni është hequr nga "lista sezonale". Përmbushja e këtij hapi konsiston në reduktimin e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë, duke e ulur në 11 (njëmbëdhjetë) numrin e rasteve që nuk janë në përputhje me rregullat e BE-së.		
--	--	--	--	--	--